

RAPORTI VJETOR 2018

*Prioritetet e Institucionit
për vitin 2019*



**AUTORITETI I
KONKURRENCËS**

PËRMBAJTJA

HYRJA	1
ASPEKTE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2018	1
FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS	4
PJESA E PARË	6
1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë	6
1.2 Akte nënligjore të miratuara nga Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2018 13	
PJESA E DYTË	15
ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS	15
2.1 Tregjet e monitoruara	15
2.2 Kontrolli i përqendrimeve	22
2.3 Tregjet e shërbimit / joprodhuese	29
2.4 Tregjet prodhuese	36
PJESA E TRETË	40
AUTORITETI I KONKURRENCËS PËRBALLË PROCESIVE GJYQËSORE ...	40
3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (2018)	40
3.2 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Apelit (2018)	41
Çështje të mbartura për gjykim nga Gjykata Administrative e Apelit (2019) - Mbeten për t'u gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit 6 (gjashtë) çështje gjyqësore, për të cilat pritet caktimi i datave respektive (Tabela 2).	42
3.3 Çështje të gjykuara nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (2018)	42
3.4 Ekzekutimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës	43
PJESA E KATËRT	45
ROLI I AUTORITETIT TË KONKURRENCËS NË FORMULIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE TË TJERA - ADVOKACIA E KONKURRENCËS	45
4.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt akteve normative	45

4.2 Advokacia e Konkurrencës	45
PJESA E PESTË	47
INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	47
5.1 Kontributi në kuadrin e Integrit Evropian.....	47
5.2 Bashkëpunimi Ndërkombëtar	47
PJESA E GJASHTË	50
ORGANIZIMI I AUTORITETIT	50
6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës.....	50
6.2 Të ardhura të derdhura në buxhet dhe realizimi i buxhetit të miratuar për AK për vitin 2018.....	50
6.3 Rekrutimet	52
PJESA E SHTATË	54
PRIORITETET E AK PËR VITIN 2019	54
7.1 Prioritetet e AK për vitin 2019	54
7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE-së.....	54
ANEKS	56
VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS	56

HYRJA

ASPEKTE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2018

Aktiviteti ekonomik i vendit, për të katërtin vit rradhazi, regjistroi një gjallërim të mëtejshëm gjatë vitit 2018. Sipas vlerësimeve¹ më të fundit, rritja e PBB-së për gjithë vitin 2018 vlerësohet të jetë 4.2 %, e mbështetur nga përmirësimi i kushteve të financimit, nga përmirësimi i klimës së biznesit, nga rritja e investimeve të huaja direkte dhe nga zhvillimet pozitive në ambientin e jashtëm. Të gjithë sektorët e ekonomisë kanë patur ecure pozitive, por që gjithsesi, më i spikatur ka qenë aktiviteti i degëve të tilla si ndërtimi, shërbimet dhe ai industrisë. Gjallërimi i ekonomisë është manifestuar në rritjen e punësimit dhe rënien e përqindjes së papunësisë, ndërkohë që si reflektim ndaj një politike konsoliduese, treguesit fiskalë paraqiten më të stabilizuar. Të dhënat buxhetore tregojnë një deficit në masën 1.6% të PBB-së në fund të vitit 2018, 0.4 pikë përqindjeje poshtë nivelit të planifikuar. Ulja e huamarrjes nga ana e sektorit publik, si dhe përdorimi i tregut ndërkombëtar si burim financimi, kanë ndihmuar në rritjen e hapësirave për kreditimin e sektorit privat.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka vazhduar të jetë në kahun lehtësues, e manifestuar në norma interesi të ulta dhe në furnizimin e tregut me likuiditet të bollshëm. Për rrjedhim, tregjet financiare kanë qenë të qeta, likuide dhe me norma interesi të favorshme për financimin e bizneseve dhe të familjeve shqiptare.

Pavarësisht zhvillimeve të mësipërme, presionet inflacioniste në ekonomi janë ende të moderuara, fakt ky që reflektohet në një normë vjetore të inflacionit poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Kursi i këmbimit njohu një trajektore forcuese në pjesën e dytë të vitit 2018, duke reflektuar kryesisht zhvillimet e favorshme në sektorin e jashtëm të vendit. Megjithatë, ecuria e tij në muajt e parë të vitit ka pësuar një lloj korrektimi si reflektim i një balancimi më të mirë midis kërkesës dhe ofertës për valutë të huaj.

Në përgjithësi pozicioni i jashtëm i vendit paraqitet më i favorshëm, kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve të huaja direkte.

Sipas raportit të Bankës Botërore “Doing Business 2019”², Shqipëria renditet në pozicionin e 63 nga 190 shtete për sa i përket lehtësirave për nisjen e bizneseve të reja. Zhvillimet ekonomike dhe lehtësimi i procedurave kanë bërë që Shqipëria të kërcejë në këtë pozicion nga pozicioni i 108 në vitin 2015. Në lidhje me renditjen e ekonomisë shqiptare referuar raportit më të fundit të konkurrueshmërisë të Forumi Ekonomik Global, në vitin 2018³, në renditjen e indeksit global të konkurrueshmërisë (GCI), u pozicionua në vendin e 76 nga krahasimi i 140 ekonomive të shteteve pjesëmarrëse duke patur përmirësim prej 10% të indeksit nga viti i kaluar.

¹ https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Kuadri_Makroekonomik_Fiskal_2020-2022.pdf

² <http://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/country/a/albania/ALB.pdf>

³ <http://www3.weforum.org/docs/GCR2018/05FullReport/TheGlobalCompetitivenessReport2018.pdf>

Mbështetur në këtë ambient të përgjithshëm ekonomik dhe financiar, Autoriteti i Konkurrencës ka ushtruar veprimtarinë e tij në përmbushje të detyrimit ligjor për të garantuar një funksionim optimal të tregjeve, duke nënkuptuar specifikuat tregje eficiente, të lira, të hapura, ku pjesëmarrësit operojnë bazuar në parimet e konkurrencës së lirë në dobi të rritjes ekonomike dhe mirëqenies së popullatës.

Konkurrenca e lirë konsiderohet si një nga shtyllat kryesore, mbi të cilat mbështetet sukcesi i ekonomisë së tregut. Në një mënyrë figurative, ajo është garanti se rregullat e lojës respektohen, duke imponuar një garë të ndershme mes aktorëve, duke garantuar efektivitet maksimal në përdorimin e kapitalit, fuqisë punëtore, kapaciteteve prodhuese dhe burimeve natyrore.

Gjatë vitit 2018, Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar në vazhdimësi një spektër të gjerë të tregjeve të mallrave dhe të shërbimeve, përfshirë dhe tregun financiar. Në vlerësim të ankesave dhe të hetimeve, është ndërhyrë në mënyrë të vazhdueshme në segmente të tilla si: tregu i karburanteve, tregu financiar dhe i sigurimeve, tregu i telefonisë celulare, tregu i energjisë, si dhe në shumë segmente të tjera.

Në mënyrë fotografike, viti 2018 mund të përmbliidhet si më poshtë:

- 23 (njëzet e tre) procedura monitorimi, nga të cilat më kryesoret mund të përmendim: tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, tregu i sigurimeve TPL, tregu i shërbimeve bankare dhe tregu i ndërmjetësimit në sigurime për bankat; tregu i transportit ajror, tregu i ngarkim-shkarkimit në Portin e Durrësit, tregu i kontrollit teknik të automjeteve, etj.;
- 3 (tre) studime, dhe hapjen e hetimeve të përgjithshme në: sektorin e arsimit të lartë, në sektorin e profesioneve të lira, si dhe tregun e shërbimit spitalor;
- 16 (gjashtëmbëdhjetë) procedura hetimore të realizuara, ku më kryesoret janë në: tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës; tregun e kontrollit teknik të automjeteve, tregun e ngarkim-shkarkimit në Portin e Durrësit, tregun e telefonisë celulare, sektorin bankar, tregun e sigurimeve, tregun e prokurimeve publike, tregun e transportit ajror, etj.;
- 87 (tëtdhjetë e shtatë) vendime të Komisionit të Konkurrencës (dy herë më tepër se viti i kaluar), nga të cilat:
 - 30 (tridhjetë) janë autorizime për përqendrime, nga të cilat 13 në tregun e brendshëm dhe 17 në tregun e jashtëm;
 - 53 (pesëdhjetë e tre) vlerësime ligjore që lidhen me situatën në tregun e energjisë elektrike, të ujit, të telefonisë, të sektorit shëndetësor e në shumë segmente të tjera.


Gjatë vitit 2018, AK ka derdhur në buxhetin e shtetit shumën totale **284,341,986 lekë**, nga të cilat është derdhur si e ardhur nga përqendimet (njoftim dhe autorizim përqendrimi) shuma **15, 237,500 lekë**, dhe si e ardhur nga vjelja e gjobave shuma prej **269,104,486 lekë**.

Për herë të parë, masa e gjobave të vjela së bashku më të ardhurat e arkëtuar nga autorizimi i përqendrimeve (284,341,986 lekë) është **3.5 herë** më i lartë së buxheti i alokuar AK (80,655,400 lekë).

Vendimet e KK për vitin 2018



Procedura hetimore në vite



FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

Viti 2018 përkon me një periudhë tejet të ngjeshur dhe sfiduese të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës në përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Ashtu si në të kaluarën, përgjatë gjithë vitit, fokus qendror i veprimtarisë së institucionit ka qenë misioni për të garantuar respektimin e rregullave të lojës së ndershme nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut.

Aktiviteti ynë ka qenë shumë dimensional. Ai është materializuar në një numër të konsiderueshëm vendimesh të marra nga ana e Komisionit të Konkurrencës, organit vendimmarrës të Autoritetit. Më konkretisht, gjatë vitit 2018 u morën **87 vendime**, ose thënë ndryshe dy herë më shumë se në vitin 2017. Në mënyrë të përmbledhur, vendimmarrja ka konsistuar në një sërë gjetjesh në formën e rekomandimeve, autorizimeve, vlerësimeve ligjore, masave të përkohshme përfshirë dhe vendimet e natyrës penalizuese.

Duke u ndalur tek kjo e fundit duhet theksuar se në **vitin 2018, u vendosën 6 gjoba**, nga të cilat u mundësua vjelja dhe derdhja në buxhetin e shtetit të vlerës 269 milionë lekë. Për herë të parë në veprimtarinë e Autoritetit, vlera e gjobave të vjela së bashku më të ardhurat e arkëtuara nga autorizimi i përqendrimeve, **rezultojnë 3.5 herë më të larta** se gjithë buxheti i veprimtarisë së vetë institucionit.

Një drejtim i rëndësishëm i veprimtarisë së institucionit ka qenë dhe ndjekja me prioritet e **rekomandimeve të lëna** nga Kuvendi i Shqipërisë në **Rezolutën** “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017”, datë 03.05.2018. Nga ky këndvështrim, Autoriteti ka arritur të adresojë të gjithë rekomandimet e lëna, nga ku duhet veçuar monitorimi në vazhdimësi i aktivitetit të ndërmarrjeve, që u janë dhënë nga shteti **të drejta ekskluzive dhe të veçanta**, për të evidentuar dhe shmangur situatat monopolistike.

Veprimtaria e institucionit ka qenë e spikatur edhe në përmbushjen e misionit ligjor në formulimin dhe zbatimin e politikave të tjera, si dhe në avokatinë e konkurrencës së lirë. Pjesë e kësaj veprimtarie ka qenë kontributi i Autoritetit në vlerësimin e një sërë dokumentesh të natyrës ligjore dhe nënligjore, duke synuar forcimin e konkurrencës në treg, minimizimin e abuzimeve me pozicionin monopol dhe uljen e përqendrimeve në ekonomi.

Një kujdes të veçantë Autoriteti i ka kushtuar komunikimit me grupet e ndryshme të interesit dhe autoritetet e rëndësishme të shtetit. Në të gjitha rastet është bërë kujdes që komunikimi të jetë sa më transparent dhe i përshtatur në përputhje me karakteristikat kryesore të çdo grupi interesi.

Autoriteti ka arritur të krijojë **marrëdhënie** efektive bashkëpunimi dhe të shkëmbimit të informacionit të ndërsjelltë me homologët e vet ndërkombëtarë. Bashkëpunimi ndërkombëtar vlerësohet i rëndësishëm, veçanërisht në drejtim të rritjes së ekspertizës, të azhurnimit me

tendencat e momentit dhe të rritjes së reputacionit të Autoritetit. Pjesë e bashkëpunimit ndërkombëtar ka qenë dhe angazhimi i pandërprerë i institucionit **në funksion të procesit të integritetit evropian të vendit.**

Dinamika e zhvillimeve ekonomike dhe financiare në vend, së bashku me objektivat madhore që ka vendi në raport me të ardhmen e tij evropiane, krijojnë në vazhdimësi një ambient të përgjithshëm sfidues për të gjithë aktorët e rëndësishëm institucionalë në fushën e vendimmarrjes dhe rregullimit.

Përrjashtim nuk bën dhe Autoriteti i Konkurrencës. **Misioni i tij unik si garantues i konkurrencës së lirë dhe efektive në treg,** do të mbetet **prioriteti madhor** i punës sonë në vitin 2019. Autoriteti do të mbetet një avokat i përkushtuar i konkurrencës së lirë dhe interesave të konsumatorit, duke besuar se vetëm në këtë mënyrë do të përmbushë synimin final për më shumë zhvillim dhe mirëqenie për të gjithë.

Ju faleminderit,

Prof.Dr. Juliana Latifi

PJESA E PARË

DREJTIMET KRYESORE TË POLITIKËS SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2018

1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna me Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017”, datë 03.05.2018, AK ka realizuar veprimtarinë e tij në këto drejtime:

Të forcojë bashkëpunimin me organet e administratës shtetërore dhe entet rregullatore, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve, dhënë nga Autoriteti i Konkurrencës në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit dhe në të mirë të të gjithë konsumatorëve shqiptarë.

AK e ka zbatuar plotësisht rekomandimin sipas Rezolutës/2017 në këtë drejtim.

AK, gjatë vitit 2018 ka vijuar bashkëpunimin me organet e administratës shtetërore dhe entet rregullatore. Ky bashkëpunim, në zbatim të nenit 69 dhe 70 të ligjit nr.9121/2003, është realizuar: *Së pari:* Nëpërmjet vlerësimit *ex-ante*, dhe *ex-post* të akteve ligjore, nënligjore të tyre, dhe akteve të tjera normative;

Së dyti: Rritja e nivelit të bashkëpunimit, nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me disa ente rregullatore, të cilat në veprimtarinë e tyre diktojnë konkurrencën në tregjet respektive që ato rregullojnë.

Janë realizuar vlerësimet ligjore të:

- 2 (dy) projektligjeve të sjella përkatësisht nga Kuvendi i Shqipërisë dhe MIE;
- 2 (dy) projekt akte normative të sjella nga MSHMS;
- 40 (dyzetë) projekt akte normative në tregun e energjisë për ERE;
- 4 (katër) projekt akte normative në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për ERRU;
- 5 (pesë) projekt akte normative në tregun e telefonisë për AKEP.

AK, në zbatim të Rezolutës/2017, ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe ente të tjera rregullatore, si më poshtë:

- Autoriteti i Konkurrencës me AKEP, nr. 286 prot., datë 04.05.2018;
- Autoriteti i Konkurrencës me ERRU, nr. 588 prot., datë 17.10.2018;
- Autoriteti i Konkurrencës me Posta Shqiptare SHA, nr. 606 prot., datë 24.10.2018;

- Autoriteti i Konkurrencës me Drejtorinë e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, nr. 620 prot., datë 01.11.2018;
- Autoriteti i Konkurrencës me Autoritetin e Mediave Audiovizive, nr. 643 prot., datë 12.11.2018.

AK, në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit dhe në të mirë të të gjithë konsumatorëve shqiptarë, për zbatimin e kësaj pikë të Rezolutës/2017, ka realizuar edhe **advokacinë e konkurrencës si një nga shtyllat kryesore të ligjit nr.9121/2003**, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit proaktiv me organet e administratës shtetërore dhe entet rregullatore, me qëllim rritjen e kulturës së konkurrencës.

- Në kuadër të rritjes dhe ndërgjegjësimit për një mjedis konkurrues, si dhe në kuadër të ditës ndërkombëtare të konkurrencës, gjatë muajve tetor-nëntor 2018 u organizuan 3 tryeza të rrumbullakëta me titull “Konkurrenca në funksion të zhvillimit ekonomik” me komunitetet e biznesit, në qytetet e Kukësit, Korçës dhe Beratit.
- Në muajin dhjetor 2018, AK zhvilloi në Tiranë forumin me temë “Konkurrenca dhe Biznesi”, në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, entet rregullatore (AKEP; ERE; Komisioneri IDP), dhe përfaqësues të biznesit (Konfindustria, Dhoma e Industrisë dhe Tregtisë Tiranë, dhe përfaqësues të studiove ligjore).

Në lidhje me plotësimin e **kuadrit nënligjor**, AK gjatë vitit 2018 dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga “Plani Kombëtar Për Integrimin Europian 2017-2020”, miratoi:

- Udhëzimin nr. 1, datë 25.06.2018 “Për kufizimet drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme me përqendrimet”;
- Rregulloren nr. 563, datë 25.10.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës”;
- Udhëzimin nr. 2, datë 20.12.2018 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës në vlerësimin e marrëveshjeve të aksesit në sektorin e telekomunikacionit”.

Të gjitha vlerësimet ligjore, nënligjore, rekomandimet dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre nga organet e administratës shtetërore dhe entet rregullatore, paraqiten sipas tabelës bashkëlidhur këtij materiali. (Tabela nr.1)

Të mbikëqyrë tregun e telefonisë celulare pas transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit “Plus Communication” sh.a. te sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a. dhe “Telekom Albania” sh.a. Të realizojë vlerësimin e tregut pas përqendrimit, mbështetur në analizën e AKEP-it, për t’u siguruar që sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e telefonisë celulare nuk sjell efekte antikonkurruese, si dhe të monitorojë ndikimin e transaksionit në tregun e shitjes me pakicë dhe në konsumatorin fundor.

AK ka realizuar plotësisht zbatimin e kësaj pike të Rezolutës/2017.

Gjatë vitit 2018, AK ka mbikëqyrur tregun e telefonisë celulare në zbatim të rekomandimeve sipas Rezolutës, pas transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit “Plus Communication” SHA te sipërmarrësit “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA në zbatim të vendimeve të KK: nr. 475, datë 21.09.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve”; nr. 484 dhe 485, datë 23.11.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes Plus Communication SHA tek Vodafone Albania SHA, dhe tek Telekom Albania SHA”.

Në zbatim të Rezolutës/ 2017 dhe vendimeve të mësipërme, është monitoruar tregu me pakicë i shërbimeve celulare duke vlerësuar ndryshimin e strukturës së tregut pas përqendrimit, zbatimin e rekomandimeve të dhëna për rregullatorin AKEP dhe ndërmarrjet që operojnë në treg; sjelljen e këtyre ndërmarrjeve lidhur me tarifën e vendosura në paketa, si dhe është bashkëpunuar me AKEP për vlerësimin e dokumenteve të nxjerra për këshillim publik nga ana e tij.

Gjithashtu në këtë treg, AK, me shkresën nr. 156/1 prot., datë 17.05.2018, dërgoi komentet e tij lidhur me pyetjet e ngritura nga AKEP-i, në dokumentin e nxjerrë për këshillim publik “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare”, i cili e miratoi këtë dokument me vendimin nr. 78, datë 01.10.2018.

AKEP-i, me vendimin nr. 82, datë 01.10.2018, nxorri për këshillim publik dokumentin për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit të shërbimeve celulare, i cili përmban propozimin e AKEP për metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve të përcaktuar me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare.

Lidhur me këtë dokument, KK vendosi dhënien e disa rekomandimeve me vendimin nr. 568, datë 15.11.2018 “Për dhënien e disa rekomandimeve AKEP në tregun e shërbimeve celulare”, rekomandime të cilat synonin rregullimin e tregut në përcaktimin e OFNT në tregun e shumicës, rregullat se si duhet të veprojnë OFNT në tregun e pakicës, si dhe krijimin e lehtësirave për hyrjen në treg të MVNO-ve, duke vendosur detyrime të qarta për ndërmarrjen me FNT për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit.

Aktualisht, AKEP e ka shfuqizuar analizën e tij për tregun e telefonisë celulare me vendimin nr. 89, datë 15.11.2018 duke vendosur ribërjen e saj.

Në lidhje me sa me sipër, jemi në pritje të nxjerrjes për këshillim publik nga AKEP të analizës së tregut të telefonisë celulare, për të realizuar vlerësimin ligjor në bazë të nenit 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003.

Të monitorojë në vazhdimësi sjelljen e ndërmarrjeve që u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive dhe të veçanta, për të evidentuar dhe shmangur situata monopolistike, si edhe të monitorojë zbatimin e rekomandimeve, dhënë organeve shtetërore nga Komisioni i Konkurrencës, sipas tregjeve që ato rregullojnë.

AK e ka zbatuar plotësisht rekomandimin sipas Rezolutës /2017 në këtë drejtim.

Lidhur me rekomandimin e mësipërm të Rezolutës/2017, AK, gjatë vitit 2018 ka kryer këto hetime ndaj ndërmarrjeve, të cilave u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive, si vijon:

a. Tregu i shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre

Shërbimi i mësipërm në Republikën e Shqipërisë ofrohet vetëm nëpërmjet ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK (SGS), e cila gëzon të drejta të përcaktuara nga marrëveshja e Koncesionit “Për dhënien me Koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio të tyre në Republikën e Shqipërisë” e nënshkruar më datë 03.09.2009.

KK, me vendimin nr. 562, datë 25.10.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve”, konstatoi abuzimin me pozitën dominuese të ndërmarrjes SGS në treg dhe **gjobitjen e saj në shumën 51,091,005 lekë (e cila është vjelë dhe ka kaluar në buxhetin e shtetit)**, detyrimin e ndërmarrjes SGS për të ndaluar shkeljen e konkurrencës dhe brenda 45 ditëve të marrë masat e nevojshme, si dhe vendosi dhënien e disa rekomandimeve për MIE për rritjen e konkurrencës në këtë treg.

b. Tregu i shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit

Shërbimi i mësipërm në Terminalin Lindor të Portit Durrës ofrohet nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, e cila gëzon të drejtat e përcaktuara në kontratën e koncesionit për menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e terminalit lindor të portit të Durrësit, nënshkruar më datë 06.05.2013.

KK, me vendimin nr. 567, datë 07.11.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe dhënien e disa rekomandimeve”, vendosi dhënien e disa rekomandimeve për nxitjen e konkurrencës në këtë treg për MIE, Autoritetin Portual Durrës dhe ndërmarrjen “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, me pozitë dominuese në këtë treg.

c. *“Tirana Airport Partners” SHPK*

Bazuar në ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare "Tirana Airport Partners" SHPK, për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza" Tiranë, dhe për dhënien e disa stimuljve kësaj shoqërie koncesionare”, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA) është aeroporti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, me anë të cilit operojnë shoqëritë ajrore të fluturimit të licencuara për realizimin e transportit ajror të pasagjerëve.

KK, me vendimin nr. 538, datë 20.07.2018 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror në Republikën e Shqipërisë”, konstatoi se OSHA dhe Koncesionari nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor të parashikuar në pikën 19. 2, gërma a), të Kontratës së Koncesionit, si dhe nuk kanë marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna nga KK në vite. KK vendosi dhënien e rekomandimeve për Këshillin e Ministrave dhe OSHA-në, si dhe i kërkoi Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, dhe Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, mbështetjen për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të AK.

Rekomandimet e dhëna nga KK kanë shërbyer si një iniciativë për institucionet shtetërore, për të bërë një vlerësim ligjor të Kontratës së Koncesionit, për të vendosur balancën ekonomike midis palëve të saj.

Të përpiqet për materializimin me objektivitet të gjithë vendimmarrjes dhe gjetjen e rrugëve për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve të marra në vite nga Komisioni i Konkurrencës.

AK e ka zbatuar në masë të konsiderueshme rekomandimin sipas Rezolutës, në këtë drejtim. Gjatë vitit 2018, AK ka derdhur në buxhetin e shtetit shumën totale: 284,341,986 lekë.

Për vitin 2018, AK ka marrë 6 (gjashtë) vendime me gjobë, duke realizuar ekzekutimin e 5 (pesë) vendimeve në shumën **57,552,486 lekë**.

Për një vendim të KK është lëshuar urdhri i ekzekutimit, por ai është pezulluar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë deri në përfundim të gjykimit të çështjes.

Përsa i përket ekzekutimit të vendimeve të marra ndër vite nga KK theksojmë faktin se është ekzekutuar gjoba e vendosur ndaj ndërmarrjes AMC SHA, me vendimin nr. 59, datë 09.11.2007 “Vendosje gjobe ndaj AMC SHA dhe Vodafone SHA”, për të cilin është lëshuar Urdhri i

Ekzekutimit nga Gjykata (urdhri nr. 3359, datë 09.11.2010, vetëm për pjesën e AMC⁴) duke çuar në buxhetin e shtetit shumën prej **211,552,000 lekë**.

Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim për 2019, Përmbarimi Shtetëror, bazuar në shkresën nr. 277/1, datë 28.12.2018 të AK, po vijon me ndjekjen e procedurave për ekzekutimin e detyrimeve, sipas informacionit të dërguar me shkresën nr. 257/2 prot., datë 4.02.2019 nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit. Gjohat që duhet të ekzekutojë Përmbarimi Shtetëror, janë në total në shumën prej **4,000,000 lekë**.

Gjithashtu, janë derdhur pranë buxhetit të shtetit edhe pagesat që kanë të bëjnë me njoftimin dhe autorizimin e përqendrimeve në vleftën **15,237,500 lekë**.

Të mbikëqyrë në vazhdimësi ato tregje ku ushtrojnë veprimtari ndërmarrje me pjesë të konsiderueshme dhe me fuqi tregu në rritje, për të garantuar zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

AK e ka zbatuar plotësisht rekomandimin sipas Rezolutës/2017 në këtë drejtim.

AK, gjatë vitit 2018, ka mbikëqyrur tregjet ku ushtrojnë veprimtari ndërmarrje me pjesë të konsiderueshme dhe me fuqi tregu, konkretisht:

- Tregu i shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve;
- Tregu i transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines;
- Tregu i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit;
- Tregu i qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro – Ushqimore në qytetin e Tiranës;
- Tregu i shërbimeve bankare;
- Tregu i importit, prodhimit dhe tregimit të miellit;
- Tregu i aktivitetit ekonomik që zhvillon Federata Shqiptare e Futbollit ;
- Tregu i prodhimit dhe tregimit të naftës bruto;
- Tregu i shërbimit spitalor.

Të përmirësojë nivelin e ekspertizës së stafit për t'iu përshtatur dinamikës së tregjeve në zhvillim e gjithmonë e më komplekse.

Ky rekomandim i Rezolutës/2017 është realizuar plotësisht.

⁴ Gjoha ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2013-1829, datë 19.09.2013 dhe vlera prej 242.633.000 lekë është ekzekutuar plotësisht sipas urdhrin për ekzekutimin e titullit ekzekutiv nr. 4281, datë 22.07.2011, duke kaluar në buxhetin e shtetit

Gjatë vitit 2018 është bërë i mundur **forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative** nëpërmjet shtimit të numrit të punonjësve me 4 inspektorë në drejtoritë teknike në strukturën e AK, të miratuar me vendimin nr. 59/2018 të Kuvendit “Për një shtesë në strukturën dhe organikën e Autoritetit të Konkurrencës”.

Nëpërmjet kësaj strukture për vitin 2018 ka funksionuar pozicioni i KryeEkonomistit, i cili ka realizuar në mënyrë të veçantë analiza ekonomike dhe ekonometrike, si dhe nëpërmjet forcimit të kësaj strukture, është menduar që në koherencë edhe me kërkesën e vazhdueshme në Progres Raportet e BE-së për Shqipërinë në kapitullin 8-të të *acquis* “Konkurrenca dhe liberalizimi”, kjo strukturë të ngrihet në nivel njësie, duke siguruar një qasje metodologjike dhe empirike të analizave sasiore dhe cilësore mbi të dhënat për të gjitha tregjet, përpara vendimarrjes së KK. Kjo njësi do të funksionojë brenda numrit të punonjësve të miratuar me strukturën e re sipas vendimit të Kuvendit nr.128/2018, datë 20.12.2018.

Janë realizuar një numër i konsiderueshëm trajnimesh brenda dhe jashtë vendit për stafin teknik të ri dhe atë ekzistues, me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale, si: 3 (tre) trajnime organizuar nga TAIEX, 4 (katër) trajnime organizuar nga OECD-GVH/RCC; CRESSE; UNCTAD, etj.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës, duke zbatuar detyrimin për të kërkuar vlerësim ligjor të AK, për çdo projekt akt normativ që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive, ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Ky rekomandim është realizuar plotësisht.

Në bashkëpunim me organet ekzekutive të të gjitha niveleve, sipas detyrave të lëna nga Rezoluta/2017, AK, në zbatim të nenit 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, ka vlerësuar aktet si më poshtë:

- 40 akte të vlerësuara për sektorin e energjisë të dërguara për mendim nga ERE;
- 5 akte të vlerësuara në tregun e telekomunikacionit të nxjerra për këshillim publik nga AKEP;
- 4 akte të vlerësuara në sektorin e ujit, të dërguara për mendim nga ERRU;
- 1 projekt vendim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ndihmën shtetërore;
- 1 projektligj nga Kuvendi për projektin dhe godinën e re të Teatrit Kombëtar;
- 1 projekt vendim i Këshillit të Ministrave “Për autorizimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për lidhjen e kontratave të posaçme (MEA)”;
- 1 projektligj nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për rezervat minimale të sigurisë së naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës për kontratat koncesionare në fuqi, të cilat sjellin deformime të konkurrencës në treg.

Rekomandimet e KK, dhënë gjatë vitit 2018 me vendimet respektive, janë në fazën e monitorimit të tyre.

Gjatë vitit 2018, KK është shprehur me vendimet e mëposhme respektive, dhe AK është në fazën e monitorimit të zbatimit të këtyre vendimeve:

a. “SGS Automotive Albania” SHPK

KK, me vendimin nr. 562, datë 25.10.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve”. Gjoha e vendosur është ekzekutuar plotësisht duke u derdhur në buxhetin e shtetit dhe jemi në fazën e monitorimit të zbatimit të detyrimeve nga ndërmarrja SGS dhe rekomandimeve nga MIE.

b. “EMS Albanian Port Operator” SHPK

KK, me vendimin nr. 567, datë 07.11.2018, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe dhënien e disa rekomandimeve për nxitjen e konkurrencës në këtë treg për MIE, APD dhe ndërmarrjen “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, me pozitë dominuese në këtë treg. Jemi në fazën e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve.

c. “Tirana Airport Partners” SHPK

KK, me vendimin nr. 538, datë 20.07.2018 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror në Republikën e Shqipërisë”, konstatoi se OSHA dhe Koncesionari nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor të parashikuar në pikën 19. 2, gërma (a), të Kontratës së Koncesionit, si dhe nuk kanë marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna nga AK me anë të vendimeve të mëparshme të KK.

Rekomandimet e dhëna nga KK kanë shërbyer si një iniciativë për institucionet shtetërore, për të bërë një vlerësim ligjor të Kontratës së Koncesionit, për të vendosur balancën ekonomike midis palëve të saj.

1.2 Akte nënligjore të miratuara nga Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2018

Në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit dhe PKIE, gjatë 2018, AK miratoi aktet nënligjore, si më poshtë:

1. *Udhëzim nr. 2, datë 20.12.2018 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës në vlerësimin e marrëveshjeve të aksesit në sektorin e telekomunikacionit”, përafruar sipas direktivës 2014/104/EU të datës 26 nëntor 2014 “Mbi rregullat lidhur me veprimet për dëmet sipas ligjeve kombëtare të shteteve anëtare dhe BE-së, për shkelje të dispozitave të ligjit të konkurrencës.”*

Ky udhëzim sjell përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë evropian në fushën e konkurrencës në kuadër të PKIE 2017-2020. Qëllimi i tij është përcaktimi i rregullave dhe procedurave që zbatohen për vlerësimin dhe analizimin e marrëveshjeve të aksesit në sektorin e telekomunikacionit.

2. *Udhëzim nr. 1, datë 25.06.2018 “Për kufizimet drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme me përqëndrimet”, përafruar sipas Sipas njoftimit të KE (2005/C 56/03) “Për kufizime drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme me përqëndrimet”.*

Rregullat e parashikuara në dispozitat e këtij udhëzimi pasqyrojnë thelbin e praktikave të KE dhe përcaktojnë parimet për vlerësimin dhe autorizimin e përqëndrimeve nga Autoritetet e Konkurrencës.

3. *Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës”, miratuar me vendim të KK nr. 563, datë 25.10.2018.*

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të nenit 24, gërma c, të ligjit nr. 9121/2003, dhe ligjit nr. 10269, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.


PJESA E DYTË

ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURENCËS

2.1 Tregjet e monitoruara

AK, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, ka realizuar monitorime, analiza dhe studime të tregjeve për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Gjatë vitit 2018 janë realizuar 23 monitorime. Tregjet e monitoruara kanë qenë:



4 (katër) tregje nuk kanë kaluar në procedura hetimore:

Tregu i therjes së mishit

Gjatë muajit janar 2018 AK realizoi një monitorim në tregun e therjes së mishit, në qarkun Fier dhe Berat. Në përfundim të monitorimit u konstatua se kuadri ligjor mbi të cilin funksionon ky

treg nuk ka patur ndryshime, që kanë të bëjnë me kriteret e licensimit dhe kontrollit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregun e therjes së mishit.

Nga monitorimi rezultoi se nuk vërehen rritje të çmimit të këtij shërbimi (therjes së mishit), e cila do të binte në kundërshtim me nenin 9 të ligjit 9121/2003.

Tregu i shitjes me shumicë dhe pakicë të karburanteve në qarkun e Gjirokastrës

Nisur nga një ankesë lidhur me aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve në qarkun e Gjirokastrës të ndërmarrjes “A” SHPK, AK në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, realizoi një monitorim në këtë treg, nga ku rezultoi se pretendimet e ngritura nga ankimesi nuk qëndrojnë, pasi nuk vërehen shenja të kufizimit të konkurrencës referuar neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 sepse ndërmarrja “A” SHPK, nuk zotëron pozitë dominuese.

Tregu i shitjes me shumicë dhe pakicë të karburanteve në qarkun e Fierit

Disa prej ndërmarrjeve, që ushtrojnë aktivitet në tregun e shitjes së karburanteve, ngritën shqetësimin mbi mënyrën e tregtimit të karburanteve në qarkun e Fierit nga ndërmarrja “K” SHPK. AK në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, realizoi një monitorim në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të karburanteve në qarkun e Fierit, për të parë nëse ka elementë që kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën në këtë treg.

Nga analiza e të dhënave të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe të dhënat e ndërmarrjes “K” SHPK, u vlerësua struktura e tregut përkatës, ku rezultoi se asnjë nga ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në këtë treg nuk ka pozitë apo shenja të kufizimit të konkurrencës në kuptim të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Tregu i shërbimit “Call Center”

Gjatë vitit 2018, AK ka monitoruar dhe marrë në analizë tregun e Call Center në lidhje me transaksionet e mundshme të realizuara në këtë treg, si dhe me paraqitjen e disa njoftimeve të përqendrimeve për transaksione të ndodhura në këtë treg, konkretisht për shërbimet e shitjeve dhe reklamimit nëpërmjet telemarketingut apo teleselling (shitjeve nëpërmjet telefonit) inbound dhe outbound. Për vlerësimin e rasteve, AK filloi procedurën e monitorimit të tregut, e cila konsistonte në evidentimin e konkurrentëve në treg, strukturën e tregut, mënyrën e kontraktimit dhe ofrimit të shërbimit, si dhe përqendrimet e tregut pas procedurave të shitblerjes së aksioneve/kuotave.

Nga dokumentacioni i administruar u konstatua se tregu i shërbimit Call Center është një treg me një numër shumë të madh konkurrentësh, ku 4 ndërmarrjet më të mëdha zotërojnë rreth 50% të tregut. Tregu vazhdon të jetë në monitorim.

6 (gjashtë) tregje të monitoruar, për të cilat KK ka vendosur hapjen e hetimit paraprak:

Tregu i qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës

AK, në muajin maj realizoi një monitorim në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës. Nga monitorimi rezultoi se disa tregtar ushtronin aktivitet në kamionë në ambientet e jashtme të këtej tregu, për arsye se nuk u janë dhënë ambiente me qira. Duke qenë se sjellja e ndërmarrjes që administron tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003, KK me vendimin nr. 512, datë 17.05.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg.

Tregu i importit, prodhimit dhe tregimit të miellit

Monitorimi në tregun e importit dhe prodhimit të miellit filloi pas depozitimit të një ankese. Nga monitorimi rezultoi se ky treg paraqitet i përqendruar, me ndërmarrje me pjesë të konsiderueshme tregu. Për sa më sipër, për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në këtë treg, KK vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregimit të miellit me vendimin nr. 551, datë 04.10.2018.

Tregu i rrjeteve të supermarketeve “Conad”

AK, nisur nga një ankesë, realizoi një monitorim në datë 10.05.2018 në rrjetin e supermarketeve “Conad”. Gjatë monitorimit rezultoi se sjellja e ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK, si shoqëri qëndrore dhe si distributor i vetëm në Shqipëri për importin e tregtimin me shumicë të produkteve me markë “Conad”, mund të përbëjë kufizim të konkurrencës, bazuar në nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9121/2003. Për këtë arsye, KK, me vendimin nr. 523, datë 07.06.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK .

Tregu i sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme

AK ka monitoruar tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme, me qëllim vlerësimin e kushteve të tregimit të këtij produkti dhe evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg. Pas monitorimit KK me vendimin nr. 509, datë 02.05.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme, për të parë nëse ka kufizime të konkurrencës në këtë treg.

Tregu i shërbimeve bankare

Sektori bankar ka qenë vazhdimisht objekt monitorimi nga AK, me qëllim vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna me VKK nr. 453, datë 07.03.2017 “Për dhënien e disa Rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë”, u realizua një monitorim në këtë sektor për vlerësimin e shërbimit të noterëve dhe vlerësuesve të pasurisë me qëllim rritjen e konkurrencës mes ofruesve të shërbimit; publikimin e Kodit të Etikës nga bankat e nivelit të dytë; marrjen e masave për lehtësimin e lëvizshmërisë së klientëve nga një bankë në tjetrën duke ulur kostot "bllokuese", si dhe rritjen e transparencës duke i bërë më të kuptueshme këto kosto për klientin; si dhe vlerësimin e strukturës së tregjeve sipas produkteve kryesore të bankës.

Në përfundim të monitorimit u konstatua se bankat ofrojnë për klientët një listë të kufizuar noterësh apo vlerësuesish të pasurisë, përqendrim në tregun e kredisë, kryesisht në produktin overdraft, komisione të larta për mbylljen e llogarisë dhe komisione në rast tërheqje CASH të paparalajmëruar dhe rritje tek komisionet për lëshimin e një vërtetimi të gjendjes së llogarisë, e cila është shumë më e lartë se vlera e publikuar në faqet zyrtare të bankës.

Mbi këto argumente, KK, me vendimin nr. 516, datë 22.05.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo.

Tregu i ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë

Pranë AK, rregullatori i tregut financiar jo-bankar, AMF, depozitoi një informacion mbi sjelljen e bankave në rolin e ndërmjetësit në sigurime (broker), të cilat lidhen me shërbimin e sigurimit të jetës dhe pronës për klientët e bankës që janë kredimarrës. KK, me vendimin nr. 526, datë 14.06.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë.

13 (trembëdhjetë) tregje të monitoruara në zbatim të VKK 2017 -2018:

Tregu i transportit detar të udhëtareve dhe automjeteve

Në zbatim të VKK nr. 467, datë 04.07.2017 “Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak”.

AK realizoi monitorim të këtij tregu, pas dhënies së vendimit, dhe pa nivelin e zbatueshmërisë së rekomandimeve, dhënë ndërmarrja “G” SHPK dhe MIE në këtë vendim. Nga monitorimi u konstatua se ndërmarrja “G” SHPK objekt monitorimi nuk ka sjellë kufizime në lidhje me klientët

në përcaktimin e çmimit të shërbimit. Periudha e monitorimit për këtë treg ishte 4.07.2017 deri 4.01.2018.

Rekomandimet drejtuar MIE me VKK të mësipërm rezulton se nuk janë zbatuar.

Tregu i furnizimit të avionëve me karburant

Ky treg në vijm të VKK nr. 470, datë 11.07.2017 “Për mbylljen e e hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonen gjeografike të TIA” është mbajtur në monitorim për një periudhë një vjeçarë dhe rezulton që nuk ka kërkesë për futjen e operatoreve të rinj në këtë treg. Periudha e monitorimit për këtë treg ishte 11.07.2017 deri në 11.07.2018.

Në lidhje me tregun e furnizimit me karburant të avionëve, rezulton se ndërmarrja Air BP Albania SHA, nuk ka marrë asnjë kërkesë formale ose joformale për akses në pajisjet e saj, në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

Tregu i shitjes me pakicë të shërbimeve celulare

KK, me vendimin nr. 475, datë 21.09.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve”, përveç disa rekomandimeve për AKEP, ka vendosur dhe monitorimin e tregut me pakicë të shërbimeve celulare për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga data 1 tetor 2017- 1 tetor 2018.

Gjithashtu, pas marrjes së vendimit të AKEP nr. 20, datë 13.11.2017 “Për dhënien paraprakisht të miratimit për transferimin e të drejtës së përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication SHA tek sipërmarrësit Telekom Albania SHA dhe Vodafone Albania SHA”, KK me vendimet nr. 484 dhe 485, datë 23.11.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes Plus Communication SHA tek Vodafone Albania SHA dhe Telekom Albania SHA, vendosi të autorizojë këto përqendrime, si dhe kryerjen e vlerësimit të tregut pas përqendrimit mbështetur në analizën e AKEP.

Për sa më sipër, AK ka monitoruar tregun me pakicë të shërbimeve celulare duke vlerësuar ndryshimin e strukturës së tregut pas përqendrimit, zbatimin e rekomandimeve të dhëna AKEP-it, KMK, dhe kompanive celulare; sjelljen e ndërmarrjeve lidhur me tarifatat e vendosura në paketa, si dhe ka bashkëpunuar me AKEP për vlerësimin e dokumenteve të nxjerra për këshillim publik.

Gjatë periudhës së monitorimit, ndërmarrjet kanë njoftuar pranë AK, lidhur me ndryshimin e tarifave të paketave që ata aplikojnë në zbatim të VKK nr. 475, datë 21.09.2017.

KK ka dhënë disa rekomandime, të cilat duhet të merren në konsideratë nga AKEP gjatë analizës dhe vendimmarrjes së tij.

AK do të vazhdojë monitorimin e këtij tregu edhe për një periudhë 3 mujore.

Tregu i importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes

Me vendimin nr. 476, datë 05.10.2017 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes” vendosi mbylljen e hetimit, si dhe monitorimin e të gjitha segmenteve të tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga 16.10.2017 deri në 16.10.2018.

Nga monitorimi janë vlerësuar strukturat e tregut përkatës, nga ku rezulton se ka një ndërmarrje të re hyrëse në këtë treg, e cila ka fituar një pjesë të konsiderueshme tregu. Gjithashtu, ndërmarrjet importuese dhe shitëse me shumicë aplikojnë çmime të ndryshme shitje nga njëra-tjetra me diferenca të dukshme, por që reflektojnë trendin e bursës PLATZ.

Për sa më sipër, tregu i importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së për ngrohje dhe konsum familjar do të mbahet në monitorim edhe për një periudhë 6-mujore për vitin 2019, duke qenë se kemi një strukturë të re tregu.

Tregu i shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës

Monitorimi i tregut të shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës vijon në zbatim të VKK nr. 479, datë 26.10.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës”. Gjatë monitorimit janë analizuar kushtet e tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë treg, është realizuar vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese “Cineplexx” SHPK dhe nuk kanë rezultuar shenja të kufizimit të konkurrencës nga kjo ndërmarrje, por sjellja e saj do të vlerësohet në vijimësi nga AK. Periudha e monitorimit është periodike çdo 6-muj brenda 10 prill dhe 10 tetor të çdo viti .

Tregu i sigurimeve për produktin Kartoni Jeshil

AK ka monitoruar tregun e sigurime për produktin Kartoni Jeshil në zbatim të VKK nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për Kartonin Jeshil” për një periudhë dy vjeçare. Për realizimin e këtij monitorimi, i cili është akoma në proces, AK ka bashkëpunuar me AMF, BSHS dhe ndërmarrjet e sigurimit, duke kërkuar informacion për zbatimin e VKK nr. 499, datë 15.02.2018 dhe rritjen e konkurrencës në këtë sektor. Monitorimi do të vijojë për të gjithë periudhën e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes, konkretisht deri në muajin shkurt të vitit 2020.

Tregu i importit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë

Pas një procedure përqendrimi, KK, me anë të vendimit nr. 504, datë 29.03.2018 “Mbi përftimin e kontrollit të shoqërisë VALTELINA SHPK nga shoqëria ALB-ERK SHPK”, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Valtelina SHPK nga shoqëria ALB-ERK SHPK, si dhe monitorimin e tregut të importit, përpunim dhe ambalazhit të kafesë për një periudhë 6 muaj nga 29.03.2018 deri 29.09.2018.

Në përfundim të procedurës së monitorimit, sipas VKK u konstatua se tregu vazhdon të mbetet një treg konkurrues, me një numër shumë të madh ndërmarrjesh, si dhe asnjë prej ndërmarrjeve, të cilat konsiderohen të mëdha nuk e kalon pjesën prej 10% të tregut në importin e kafesë së të gjitha llojeve dhe sjellja e ndërmarrjeve pas përqendrimit është e njëjtë duke mos sjellë dyshime për kufizim të konkurrencës në kuptim të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003.

Tregu i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit

KK, me vendimin nr. 505, datë 29.03.2018 “Për mbyjjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit, dhe dhënien e rekomandimit për MBZHR” ka lënë në monitorim këtë treg për periudhën 01.12.2017 deri 01.12.2018.

Rekomandimi i KK është zbatuar tërësisht.

Tregu i transportit ajror, ndërmarrja Austrian Airlines

AK është duke monitoruar sjelljen e ndërmarrjes Austrian Airlines që operon në tregun e transportit ajror në zbatim të VKK nr. 525, datë 14.06.2018 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines dhe dhënien e disa rekomandimeve”, e cila do të vazhdojë monitorimin për një periudhë 1 vjeçare, konkretisht deri në muajin qershor 2019.

Tregu i shërbimeve të subjekteve financiare jobankë

KK, me vendimin nr. 537, datë 20.07.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të BFSE HOLDING B.V tek shoqëria AMRYTA CAPITAL LLP”, vendosi që tregu i kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare dhe faktoringut, të ofruara nga SFJB-të, të jetë objekt monitorimi për një periudhë prej 1 viti nga data e shpalljes së vendimit.

Monitorimi ka për qëllim vlerësimin e sjelljes së subjekteve në lidhje me interesat e kredive të ofruara, në të gjitha format, komisionet e aplikuara për shërbimet, si dhe fleksibilitetin e levizshmërisë së klientëve mes ofruesve të shërbimit. Tregu do të vazhdojë të jetë në monitorim deri në muajin korrik 2019.

Tregu i shërbimeve spitalore

KK, me vendimin nr.539, datë 24.7.2018 “Mbi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Hygeia Hospital Tirana SHA nga Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens, Hygeia S.A tek American

Hospital SHA” vendosi monitorimin për spitalin American Hospital SHA një periudhë 1 vjeçare 24.07.2018 deri në 24.07.2019.

Në kuadër të një studimi të realizuar në tregun e shërbimeve spitalore, ky monitorim do të jetë pjesë e hetimit të përgjithshëm të hapur në këtë treg me vendimin nr. 552 datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në tregun e shërbimit spitalor”.

Tregu i rrjeteve të supermarketeve “Conad”

KK, me vendimin nr.560, datë 15.10.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Conad Albania SH.P.K në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore, të cilat mbartin markën Conad në RSH dhe vendosjen e disa detyrimeve” vendosi monitorimin e këtij tregu për periudhën 1 vjeçare 15.10.2018 deri në 15.10.2019.

Vendimi i KK është ankimuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.


Tregu i shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit

KK, me vendimin nr. 567, datë 07.11.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe dhënien e disa rekomandimeve”, ndër të tjera ka vendosur monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK për një periudhë 1 (një) vjeçare. Gjatë periudhës së monitorimit, ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK duhet të raportojë çdo 3 (tre) muaj pranë Autoritetit të Konkurrencës të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi dhe marrëdhëniet me palët e treta. Në zbatim të këtij vendimi të KK, sjellja e ndërmarrjes EMS Albanian Port Operator do të vlerësohet në vijimësi për një periudhë 1 (një) vjeçare nga 07.11.2018 deri 07.11.2019.

2.2 Kontrolli i përqendrimeve


Gjatë vitit 2018, AK, në zbatim të neneve 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121/2003, realizoi vlerësimin e 39 rasteve të njoftuara të përqendrimeve, nga të cilat 30 janë autorizuar nga KK dhe 9 prej tyre nuk kanë plotësuar kriteret e ligjit nr. 9121/2003.

Sektorët e ekonomisë me numrin më të madh të transaksioneve për vitin 2018:



Nga vlerësimi i përqendrimeve rezulton se:

- 44% e rasteve të njoftuara janë transaksione që kanë ndodhur në tregun e jashtëm, 17 vendime autorizimi;
- 33% e rasteve të njoftuara janë transaksione, që kanë ndodhur në tregun shqiptar, 13 vendime autorizimi;
- 23% janë njoftime, të cilat nuk kanë përmbushur kriteret për t'u autorizuar nga KK, 9 vlerësime ligjore.



2.2.1 Transaksione në tregun e brendshëm

Në rastet e transaksioneve të njoftuara në tregun shqiptar, AK ka vlerësuar si më poshtë vijon:

Tregu për akomodim - hoteleri dhe turizëm

KK, me vendimin nr. 494, datë 24.01.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë të shoqërisë Mak Albania SHPK nga shoqëria Kastrati SHA” vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaqte shenja të kufizimit

të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Tregu financiar(bankar) dhe i sigurimeve

Në këtë treg gjatë vitit 2018 janë realizuar 6 procedura përqendrimi, nga të cilat 4 transaksione kanë ndodhur në tregun shqiptar.

- Banka Amerikane e Investimeve SHA/Banka Kombëtare e Greqisë S.A/Banka NBG Albania SHA

KK, me vendimin nr. 501, datë 15.03.2018 “Mbi shitjen dhe transferimin e aksioneve të Bankës NBG Albania SHA, nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A tek Banka Amerikane e Investimeve SHA” vendosi të autorizojë përqendrimin, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese. Pas përqendrimit BAI do të zotërojë 6% të tregut.

- IuteCredit Albania SHA/Final SHA

KK, me vendimin nr. 534, datë 05.07.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të 100% të aksioneve të shoqërisë Final SHA tek Iutecredit Albania SHA” vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se përqendrimi nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese. Pas përqendrimit IuteCredit Albania SHA do të zotërojë 4.9% të tregut të shërbimeve të ofruara të subjekteve financiare jobankë.

- OTP Bank Nyrt/Societe Generale & Societe Generale Albania SHA

KK, me vendimin nr. 571, datë 22.11.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së aksioneve prej 88.89% tek Societe Generale Albania SHA nga Societe Generale tek OTP Bank Nyrt” vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se transaksioni nuk sjellë ndryshim të strukturës së tregut. Pas përqendrimit OTP Bank do të zotërojë 6% në tregun e aktiveve e depozitave dhe 8% në tregun e kredive.

- Union Bank SHA/Banka Ndërkombëtare Tregtare SHA

KK, me vendimin nr. 576, datë 11.12.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare SHA nga Union Bank SHA” vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese. Pas përqendrimit Union Bank do të zotërojë 4% të tregut bankar.

Tregu i automjeteve dhe i pjesëve të këmbimit

Në këtë treg, gjatë vitit 2018 janë realizuar 5 procedura përqendrimi, nga të cilat 1 transaksion ka ndodhur në tregun shqiptar.

- Bolv Oil SHA/Autovizion SHA

KK, me vendimin nr. 528, datë 25.06.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 89% të aksioneve të Autovizion SHA tek Bolv Oil SHA” vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si dhe të gjobisë shoqërinë Bolv Oil SHA në masën 500,000 lekë për mosnjofitim brenda afateve të parashikuara në nenin 12, pika 2 e ligjit nr. 9121/2003. Pas përqendrimit, Bolv Oil do të zotërojë 0.14% të tregut të importit të pjesëve të kembimit për automjete, 2.8% të tregut të importit të vajrave për automjete, 3.8% të tregut të importit të benzinës dhe 2.9% të tregut të importit të diesel 10 ppm.

Tregu i shitjes me pakicë

Në këtë treg, gjatë vitit 2018 janë realizuar 4 procedura përqendrimi, nga të cilat 1 transaksion ka ndodhur në tregun shqiptar.

- Alb-Erk SHPK/Valtelina SHPK

KK, me vendimin nr. 504, datë 29.03.2018 “Mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë Valtelina SHPK nga shoqëria Alb-Erk SHPK”, vendosi të autorizojë përqendrimin e njoftuar, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të dukshme të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, por për të parë efektet që do të sillte në treg ky transaksion, si dhe të gjobisë shoqërinë Alb-Erk SHPK në masën 971,200 lekë për mosnjofitim të transaksionit brenda afateve të përcaktuara në nenin 12, pika 2 e ligjit. Pas përqendrimit Alb-Erk do të zotërojë 35% të tregut importit, përpunimit dhe tregtimit të kafesë. Gjithashtu, ky treg u monitorua për një periudhë 6 muaj nga data e shpalljes së vendimit.

Tregu i transmetimeve audiovizive

Në këtë treg, gjatë vitit 2018 janë realizuar 3 procedura përqendrimi, nga të cilat 1 transaksion ka ndodhur në tregun shqiptar.

- Z.A. F/Z.E.GJ/TV Klan SHA

KK, me vendimin nr. 513, datë 17.05.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 20% të aksioneve të TV Klan SHA nga Z. E. Gj. tek Z. A. F.” vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese. Pas përqendrimit, TV Klan do të zotërojë 20% të tregut të transmetimeve audiovizive.

Tregu i infrastrukturës dhe shërbimit të transportit ajror

Në këtë treg, gjatë vitit 2018 është realizuar 1 procedurë përqendrimi dhe ky transaksion ka ndodhur në tregun shqiptar.

- Air Albania SHPK

KK, me vendimin nr. 549, datë 27.09.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët Air Albania SHPK”, vendosi të autorizojë këtë përqendrim,

pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Tregu i energjisë

Në këtë treg, gjatë vitit 2018 është realizuar 1 procedurë përqendrimi dhe ky transaksion ka ndodhur në tregun shqiptar.

- Shushica Hydropower SHPK

KK, me vendimin nr. 519, datë 31.05.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një shoqërie të përbashkët, Shushica Hydropower SHPK, nga Trema Engineering 2 SHPK, GR Albania SHPK dhe ALB-STAR SHPK”, vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Transaksione në tregje të tjera

Gjatë vitit 2018 janë realizuar 6 procedura përqendrimi, nga të cilat 3 transaksione kanë ndodhur në tregun shqiptar, përkatësisht në tregjet e qiradhënies; shërbim lavanderie, dezinfektim dhe pastrim kimik; shërbime shëndetësore dhe spitalore.

- Z.G.J, Z.P.K/InRE SHPK

KK, me vendimin nr. 507, datë 02.05.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 100 % të shoqërisë InRE SHPK tek Z.G. J. dhe Z.P.K”, vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

- Servizi Italia S.P.A/Z.F.D/Sanitary Cleaning SHPK

KK, me vendimin nr. 524, datë 14.06.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit në shoqërinë Sanitary Cleaning SHPK”, vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese. Pas përqendrimit, Sanitary Cleaning SHPK do të zotërojë 4.71% të tregut të lavanterisë, pastrimit kimik dhe shërbimeve të desifektimit.

- American Hospital SHA/Hygeia Hospital Tirana SHA

KK, me vendimin nr. 539, datë 24.07.2018 “Mbi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Hygeia Hospital Tirana SHA nga Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens, Hygeia S.A tek American Hospital SHA”, vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, si dhe të monitorojë për 1 vit sjelljen e shoqërisë pas përqendrimit, dhe detyrimin për njoftim pranë AK për çdo ndryshim të çmimit të shërbimeve të

ofruara. Pas përqendrimit, American Hospital SHA do të zotërojë 11.5% të tregut të shërbimeve spitalore.


2.2.2 Transaksione në tregun e jashtëm

Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 9121/2003, objekt i vlerësimit të përqendrimit janë rastet, të cilat ndodhin në tregun e jashtëm, por që realizojnë të ardhura në tregun shqiptar në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë. KK, për vitin 2018, ka autorizuar 17 raste të tilla me anë të vendimeve të renditura më poshtë:

1. Vendimi nr. 496, datë 08.02.2018 “Mbi përftimin e kontrollit të plotë të shoqërisë Buse Gaz S.r.l. nga Messer Belgium N.V. në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar tërësisht prej saj Messer Romania S.r.l.”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i gazeve industriale.
2. Vendimi nr. 502, datë 21.03.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të Nestle USA Inc. nga Ferrero International S.A”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsideruan tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave prej çokollate; tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave prej sheqeri.
3. Vendimi nr. 508, datë 02.05.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të shoqërisë Turgut Ozal Education SHA tek shoqëria BF Cooperatief U.A.”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ofrimit të shërbimeve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit.
4. Vendimi nr. 510, datë 10.05.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 6.50 % të aksioneve të Intelligent Apps GMBH, nga HNH Group Ltd tek Daimler Mobility Services GMBH”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimit të taksive.
5. Vendimi nr. 511, datë 10.05.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit në lidhje me përftimin e kontrollit të përbashkët nga BMW dhe Daimler AG mbi disa shoqëri”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i të gjitha shërbimeve të transportit për pasagjerë.
6. Vendimi nr. 529, datë 25.06.2018 “Mbi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Sport Vision d.o.o. Podgorica, Mali i Zi nga Sport Vision d.o.o. Bijeljina, Bosnje Hercegovina”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të artikujve sportiv.
7. Vendimi nr. 533, datë 05.07.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të vetëm të Sky PLC nga Comcast Corporation”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i prodhimit dhe ofrimit të përmbajtjes televizive, furnizimit me shumicë të kanaleve televizive dhe furnizimit me pakicë të shërbimeve televizive.
8. Vendimi nr. 536, datë 20.07.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit nga United Media mbi Direct Media, Media Point, Pink BH dhe Pink

- MNE”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ofrimit të shërbimeve të komunikimit të marketingut dhe blerjes të medias.
9. Vendimi nr. 537, datë 20.07.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të BFSE Holding B.V tek shoqëria Amryta Capital LLP”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare dhe faktoringut të ofruara nga subjektet financiare jobankë.
 10. Vendimi nr. 540, datë 24.07.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të Siemens AG me Alstom SA”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i furnizimit me mjete lëvizëse, sinjalizimit dhe elektrifikimit të hekurudhave.
 11. Vendimi nr. 554, datë 08.10.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit nga Messer Group GmbH dhe Yeti Investments S.a.r.l mbi disa asete të Linde Aktiengesellschaft dhe Praxair Inc nëpërmjet MG Industries GmbH”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i gazeve industriale.
 12. Vendimi nr. 555, datë 08.10.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit nga INA Industrija Naftë d.d. dhe Prvo Plinarsko Drustvo d.o.o mbi Petrokemija d.d”. Shoqëria target dhe palët në marrëveshje operojnë në tregje te ndryshme produkti dhe duke qenë se transaksioni nuk sjellë asnjë efekt mbi konkurrencën në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikës së Komisionit Evropian në çështje të ngjashme.
 13. Vendimi nr. 556, datë 08.10.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërive First Data Slovakia S.R.O dhe First Data Hellas Processing Services and Holdings S.A. nga shoqëria SIA S.p.A”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i përpunimit të pagesave me kartë, i përpunimit të ATM dhe i ofrimit të terminaleve POS dhe shërbimet e lidhura me to.
 14. Vendimi nr. 559, datë 15.11.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët mbi një ndërmarrje të re të krijuar nga Dr.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft dhe Schuler Aktiengesellschaft”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu për prodhimin e pjesëve metalike.
 15. Vendimi nr. 565, datë 29.10.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të Gorenje Gospodinjski Aparati D.D. nga Hisense Group CO. LTD”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i importit dhe shitjes me pakicë i paisjeve shtëpiake.
 16. Vendimi nr. 566, datë 07.11.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët nga Daimler FS dhe nga Volksëagen FS mbi Mobility Trader Holding GmbH”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua platforma online për shitjen e automjeteve të përdorura.
 17. Vendimi nr. 570, datë 22.11.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të Danske Commodities A/S nga Equinor Refining Norëay AS”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu me shumicë i energjisë elektrike.

2.3 Tregjet e shërbimit / joprodhuese



2.3.1 Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjes

Tregu i sigurimeve për produktin Kartoni Jeshil

Pranë AK, është njoftuar marrëveshja mbi shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil, nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimeve, përkatësisht: “Sigal Uniqa Group Austria” SHA, “Intersig VIG” SHA, “Atlantik” SHA, “Sigma Inter Albanian VIG” SHA, “Albsig” SHA “Eurosig” SHA “Ansig” SHA dhe “Insig” SHA.

KK, me vendimin nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil” vendosi: Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të parashikuara shprehimisht në këtë vendim.

2.3.2 Marrëveshjet e ndaluara

2.3.2.1 Hetime të përfunduara

Tregu i sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme

KK, me vendimin nr. 561, datë 15.10.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme”, vendosi ndërmejt të tjerave: T’i rekomandojë AMF-së që brenda afatit 90 ditor: (1) Të miratojë primin e riskut për çdo kompani sigurimi mbështetur në raportin e përgatitur nga aktuari i kompanisë duke mos miratuar dhe orientuar një prim risku të njëjtë për të gjithë tregun e MTPL; (2) Të marrë masat për ndalimin e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;

(3) Të marrë masat për të lejuar shfaqjen në sistemet e tregtimit që përdoren nga agjentët vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilit vepron; (4) Të ndalojë agjentët të tregtojnë për llogari të kompanive të tjera të sigurimit, për të cilat nuk janë të licencuar; (5) Të parashtrijë përpara AK duke kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore për çdo rast, për të cilin konstaton sjellje antikonkurrese nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

Për nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, si dhe për të shmangur çdo sjellje të mundshme anti konkurrese, ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, brenda afatit 90 ditor: (1) Të ndalojnë tregtimin e policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit; (2) Agjentët/punonjësit e kompanive të sigurimit të tregtojnë vetëm për llogari të kompanisë së sigurimit për të cilën është licencuar.

Monitorimin e tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta nga AK për një periudhë 6 (gjashtë) mujore.

Tregu i Prokurimeve Publike

Në përfundim të hetimit të thelluar u konstatua një marrëveshje në oferta në procedurën e prokurimit publik “Kërkesë për Propozim” me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë” në Bashkinë Himarë, midis këtyre ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK, e cila përbën një marrëveshje të ndaluar në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të ligji nr. 9121/2003 dhe KK me vendimin nr. 535, datë 17.07.2018 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve ‘Tea-D’ SHPK dhe ‘A.E.K. & CO’ SHPK për marrëveshje të ndaluar në tregun e prokurimeve publike”, vendosi: (1) Konstatimin e pavlefshmërisë së marrëveshjes së ndaluar midis ndërmarrjeve në procedurën e prokurimit publik (2) Gjorbitjen e ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK për shkelje të rëndë të konkurrencës, përkatësisht në shumën 100,000 (një qind mijë) lekë për secilën.

Gjoba e vendosur nga KK me vendimin e mësipërm është ekzekutuar plotësisht dhe vendimi është dërguar pranë APP-së, e ka përjashtuar nga procedurat e prokurimit publik dy ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë marrëveshje të ndaluar.

Tregu i shitjes me pakicë të shërbimeve celulare

KK, me vendimin nr. 475, datë 21.09.2017, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve për AKEP dhe për KMK. Në bazë të pikës 3 të dispozitivit të këtij vendimi, ndërmarrjet që operojnë në tregun e telefonisë celulare, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi duhet të marrin masa për aplikimin dhe publikimin e çmimit për njësi për çdo shërbim (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB, etj.) që përmbajnë paketat standarde, duke informuar AK.

Referuar detyrimit të mësipërm, rezulton se ndërmarrjet “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA, deri në datë 21 dhjetor 2017, kur dhe mbaron afati i vendosur nga KK për zbatimin e detyrimit sipas pikës 3 të VKK nr. 475, datë 21.09.2017, nuk kanë depozituar asnjë informacion pranë AK lidhur me masat e marra për aplikimin dhe publikimin e çmimit për njësi për çdo shërbim (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB, etj.) që përmbajnë paketat standarde.

Për sa më sipër, KK, me vendimin nr. 495, datë 08.02.2018 vendosi “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA për mospërmbushjen e detyrimit të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin nr. 475, datë 21.09.2017.

Gjoha e vendosur nga KK me vendimin e mësipërm është ekzekutuar plotësisht.

Gjithashtu, KK, me vendimin nr. 568, datë 15.11.2018 “Për dhënien e disa rekomandimeve AKEP Postare në tregun e shërbimeve celulare”, bazuar në vendimin nr. 82, datë 01.10.2018 të AKEP vendosi ndër të tjera: T’i rekomandojë AKEP: (1) Tarifa e akses origjinimit për ndërmarrjen me FNT Vodafone duhet të jetë e orientuar drejt kostos; (2) Aplikimin e testit të margin squeeze përpara hedhjes në treg të paketave nga ndërmarrja me FNT për të eliminuar sjelljet antikonkurrese të ndërmarrjes me FNT lidhur me ngjeshjen e çmimit dhe nxjerrjen e konkurrentëve nga tregu nëpërmjet aplikimit të tarifave të ulëta të pakicës; (3) Të vendosë nën rregullim tarifat e shërbimeve celulare me pakicë për ndërmarrjen me FNT, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9918/2008 të njëkohshme me tregun me shumicë akses origjinimit, për nxitjen e konkurrencës efektive në këtë treg, pa pritur rezultatet e rregullimit të tarifave të tregut të akses origjinimit; (4) Krijimin e lehtësirave për hyrjen në treg të MVNO-ve, duke vendosur detyrime të qarta për ndërmarrjen me FNT për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit.

Aktualisht AKEP do të kryejë analizën e tregut të telefonisë celulare dhe AK do të shprehet në vijim lidhur me dokumentet që do të nxirren për këshillim publik.

2.3.2.2 Hetime në vijim

Tregu bankar

AK, në mbështetje të vendimit nr. 453, datë 07.03.2017 “Për dhënien e disa Rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë” vendim i cili u bazua në Hetimin e Përgjithshëm të këtij tregu, gjatë vitit 2018 hapi dy hetime në tregun bankar përkatësisht:

KK, me vendimin nr. 516, datë 22.05.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo, nëse ka elemente të shkeljeve të parashikuar në nenin 4 dhe 9 të ligjit në tregun e shërbimeve bankare.

KK, bazuar në ankesën e një prej shoqërive të sigurimit dhe informacionit të përcjellë nga AMF, me vendimin nr. 526, datë 14.06.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime e jetës dhe jo jetës nga bankat e nivelit të dytë.

Aktualisht procedurat hetimore të hapura me VKK e mësipërme janë në vijim.

2.3.3 Abuzimi me pozitën dominuese

2.3.3.1 Hetime të përfunduara

Tregu i shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre

KK, me vendimin nr. 562, datë 25.10.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve”, vendosi ndër të tjera: (1) Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK; (2) Gjykitjen e ndërmarrjes për shkelje të konkurrencës, në masën 5.69 % të xhiros totale të ndërmarrjes për vitin paraardhës financiar (2017), përkatësisht në shumën 51,091,005 (pesëdhjetë e një milion e nëntëdhjetë e një mijë e pesë) lekë; (3) Detyrimin e ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK për të ndaluar shkeljen e konkurrencës dhe brenda 45 ditëve të marrë masat e nevojshme; (4) T’i rekomandohet MIE si vijon: (i) Liberalizimin e tregut në drejtim të ofrimit të këtij shërbimi, duke përfshirë edhe ofrimin e shërbimit të servisit, sikurse pjesa më e madhe e vendeve të BE e ofron; (ii) Për kohën e vazhdimin të këtij koncensionari, brenda një afati prej 90 ditëve të miratohet një rregullore për funksionimin dhe monitorimin e koncensionarit SGS, ku të jenë përcaktuar në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat, shërbimet që ofrohen nga ana e tij.

Gjoba e vendosur nga KK me vendimin e mësipërm është ekzekutuar plotësisht. Jemi në pritje të zbatimit të rekomandimeve nga MIE.

Tregu i transportit ajror të udhëtarëve

KK, me vendimin nr. 525, datë 14.06.2018 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines dhe dhënien e disa rekomandimeve”, vendosi ndërmjet të tjerave: (1) Austrian Airlines, ndërmarrja me pozitë dominuese në tregun përkatës, e cila ka një detyrim të veçantë për t’u sjellë në treg ndaj pasagjerëve të saj, për të mos i vendosur ata në kushte të pafavorshme konkurrence, në zbatim të Kodit Ajror dhe Udhëzimit nr. 1, datë 26.02.2013 “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës gjatë fluturimeve”, duhet: (i) T’i paraqesë çdo pasagjeri

të dëmtuar nga refuzimi i hipjes në avion ose anulimi i fluturimit një njoftim me shkrim ku ti bëhet e ditur e drejta e kompensimit dhe e asistencës, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 26.02.2013; (ii) Të minimizojë sa më shumë të jetë e mundur tregtimin e biletave mbi kapacitetin e avionit, për të shmangur ndonjë sjellje të mundshme antikonkurruese në treg dhe në mënyrë të veçantë gjatë sezonit të lartë. (2) Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim, ndërmarrja Austrian Airlines ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës. (3) Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Austrian Airlines që operon në tregun e transportit ajror për një periudhë 1 vjeçare, duke raportuar pranë AK çdo 4 muaj në lidhje me çmimet që ka aplikuar, numrin e ankesave që ka patur, raste të overbooking. (4) AAC, në zbatim të Kodit Ajror dhe Udhëzimit nr. 1, datë 26.02.2013, t'i rekomandohet që brenda një afati 90 ditor: (i) Të kryejë analizën e çmimeve të aplikuara nga transportuesit ajrorë me pozitë dominuese në treg, për të parandaluar tarifat dhe praktikat diskriminuese, çmimet abuzivisht të larta si rezultat i një pozite dominuese dhe çmimet abuzivisht shumë të ulëta. (ii) Të kërkojë nga organi menaxhues i aeroportit të sigurojë që informacioni i përgjithshëm mbi të drejtat e udhëtarëve të shfaqet në mënyrë të qartë dhe të dukshme brenda aeroportit me qëllim që të sigurojë që pasagjerët e pranishëm në aeroport të informohen për anulimin e fluturimit të tyre dhe për të drejtat e tyre.

AK është në proces të monitorimit të zbatimit të këtij vendimi nga ndërmarrja Austrian Airlines dhe AAC.

Tregu i transportit ajror TIA

KK, me vendimin nr. 538, datë 20.07.2018 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror në Republikën e Shqipërisë”, konstatoi se OSHA dhe koncesionari nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor të parashikuar në pikën 19. 2, gërma (a), të kontratës së koncesionit, si dhe nuk kanë marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna nga AK me anë të vendimeve të mëparshme të KK.

KK vendosi dhënien e rekomandimeve për Këshillin e Ministrave dhe OSHA-në, si dhe i kërkoi Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, dhe Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, mbështetjen për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të AK.

Rekomandimet e dhëna nga KK kanë shërbyer si një iniciativë për institucionet shtetërore, për të bërë një vlerësim ligjor të Kontratës së Koncesionit, për të vendosur balancën ekonomike midis palëve të saj.

Tregu i rrjeteve të supermarketeve “Conad”

KK, me vendimin nr. 560, datë 15.10.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregimit të produkteve ushqimore, të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve”, vendosi:

(1) Ndërmarrja “Conad Albania” SHPK, për të shmangur çdo kufizim të konkurrencës nga aplikimi i përcaktimi i çmimeve të rishitjes, duhet të marrë ndërmjet të tjerave masat : (i) të mos aplikojë në faturat e shitjeve (brenda sistemit software dhe jashtë sistemit software), çmime të këshilluara dhe marzhin teorik; (ii) brenda 60 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi të informojë Autoritetin e Konkurrencës lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimit të mësipërm. (2) Në rast të mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim, ndërmarrja “Conad Albania” SHPK ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës. (3) Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK për një periudhë 1 vjeçare.

Në procedurat hetimore të këtij rasti, AK mori në konsideratë edhe kërkesat për informacion (RFI), në rrjetin OECD-GVH/RCC, ku shkëmbehet eksperiencia ndërkombëtare ndërmjet vendeve anëtare.

Vendimi i KK është ankimuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

Tregu i shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit

KK, me vendimin nr. 567, datë 07.11.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe dhënie të disa rekomandimeve”, vendosi ndër të tjera: (1) T’i rekomandojë MIE, që brenda një afati 90 ditor, të marrë masat (i) Verifikimin dhe vlerësimin e pajtueshmërisë së funksionimit aktual të shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mallrave në port (si kategori e shërbimeve portuale) me kuadrin ligjor rregullator përkatës në fuqi dhe plotësimin e bazës ligjore/nënligjore (nëse do rezultojë e nevojshme) për funksionimin e duhur të tregut të shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mallrave në port; (2) APD, brenda 90 ditëve duhet të marrë masa për: (a) Miratimin e një rregulloreje për funksionimin e Terminalit Lindor të Portit Durrës, ku të jenë përcaktuar, ndër të tjera: (i) Procedurat për sigurimin e shërbimeve që ofrohen nga ana e koncesionarit EMS APO; (ii) Funksionimi i agentit detar dhe atij spedicioner, si përfaqësues respektivë të pronarit/charteruesit të mjetit lundrues dhe pronarit të mallrave në raport me të drejtën për të përzgjedhur operatorin e licencuar stivador; (b) Draft-rregullorja përpara miratimit të dërgohet paraprakisht për mendim pranë AK. (3) T’i rekomandojë ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj në tregun përkatës: (a) Të aplikojë kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore; (b) Në lidhjen e kontratave me palët e tjera të mos vendosë kushte/detyrime shtesë, të cilat për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë; (c) Mënyra e përpunimit të anijeve të kryhet sipas parimit “*kush hyn i pari, shërbehet i pari*”; (4) Në rast të mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim, ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.

Lidhur me rekomandimet, APD ka informuar në lidhje me fillimin e procedurës së hartimit të rregullores për funksionimin e Terminalit Lindor të Portit Durrës. Rekomandimet e dhëna MIE janë hartuar në bashkëpunim me ministrinë dhe jemi në pritje të zbatimit të tyre nga ana e saj.

AK është në pritje të zbatimit të të gjithë rekomandimeve të dhëna me VKK nr. 567, datë 07.11.2018 dhe vazhdon të ketë në monitorim tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.

2.3.3.2 Hetime në vijim

Tregu i veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit

KK, me vendimin nr. 564, datë 25.10.2018 vendosi “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”. FSHF kryen aktivitet ekonomik lidhur me shitjen e të drejtave të transmetimit, shitjen e biletave, transferimin e lojtarëve, shpërndarjen e artikujve komercialë, lidhjen e kontratave të reklamave dhe sponsorizimit, i cili sipas parashikimeve të ligjit nr. 9121/2003 dhe sipas praktikës së BE-së dhe vendeve anëtare të saj, përfshihet në objektin e veprimtarisë dhe fushën e zbatimit të ligjit nr. 9121/2003. Përveç aktiviteteve të zakonshme ekonomike, FSHF-së i janë dhënë edhe disa të drejta ekskluzive, nga shitja e të cilave gjenerohen të ardhura dhe për shkak të këtij ekskluziviteti FSHF-ja zotëron pozitë dominuese në kuptim të nenit 8 të ligjit nr. 9121/2003.

2.3.4 Hetime të përgjithshme

Tregu i shërbimeve spitalore

KK, me vendimin nr. 552, datë 04.10.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në shërbimin spitalor, pasi realizoi një vlerësim të tregut të shërbimeve shëndetësore me fokus shërbimin spitalor me synimin për të realizuar një analizë të plotë të konkurrencës në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimit dhe efikasitetit ekonomik, edhe pas transaksioneve të cilat kanë ndodhur në këtë treg.


Sektori i arsimit të lartë

AK realizoi një vlerësim në sektorin e arsimit të lartë në sektorin publik e privat, dhe me vendimin nr. 573, datë 26.11.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin e arsimit të lartë me qëllim kryerjen e një analizë të plotë në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar, si nga IAL-të publike dhe ato private, si dhe respektimin e rregullave të konkurrencës në këtë treg.

Sektori i Profesioneve të Lira

KK, me vendimin nr. 574, datë 26.11.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin e profesioneve të lira konkretisht për shërbimet e ofruara nga noterët, avokatët dhe vlerësuesit e pasurive të paluajtshme, veçanërisht në shërbimet që ato ofrojnë në sistemin bankar.

2.4 Tregjet prodhuese



2.4.1 Abuzimi me pozitën dominuese

2.4.1.1 Hetime të përfunduara

Tregu i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit

KK, me vendimin nr. 505, datë 29.03.2018 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit dhe dhënien e rekomandimit për MBZHR”, vendosi ti rekomanoj asaj që: Në projektligjin “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar”, të ketë në konsideratë Vendimet e mëparshme të KK, ku në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar”, të shtohet një pikë ku të përcaktohet bashkëpunimi i Agjencia Kombëtare e Duhan Cigares (AKDC) me AK në rastet kur dyshon për një sjellje të mundshme antikonkurruese të ndërmarrjeve që operojnë në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit. Rekomandimi i dhënë me vendimin e KK është zbatuar plotësisht.

Tregu i shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura

ERRU, gjatë vitit 2018, ka përcjellë pranë AK për mendim disa vendime të Komisionit Kombëtar Rregullator së bashku me informacionin mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor, si dhe projekt vendimet përkatëse “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë”. Pas

shqyrtimit dhe vlerësimit të informacionit të depozituar, në zbatim të neneve 69 dhe 70 të ligjit 9121/2003, KK është shprehur me disa vendime, si vijon:

1. Vendimi nr. 522, datë 07.06.2018 “Për dhënien e disa rekomandimeve ERRU mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për “Ujësjetës Gramsh” SHA”, me anë të të cilit KK ka vendosur midis të tjerave që t’i rekomandojë ERRU, që në vendimarrjen e saj të përcaktohet detyrimi i ndërmarrjes Ujësjetës Gramsh SHA për të bërë sa më transparente subvencionet që do të përfitojë për mbulimin e kostove, si dhe investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjetës, duke i përdorur ato në mënyrë sa më të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, me qëllim reduktimin e kostove nga niveli aktual dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
2. Vendimi nr. 518, datë 22.05.2018 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për “Ujësjetës Kanalizime Skrapar” SHA”, nëpërmjet të cilit KK ka vendosur: (1) Të mos pranojë propozimin e bërë nga ERRU për UK Skrapar, sepse dokumentacioni i paraqitur është i paplotë dhe i pamjaftueshëm për të realizuar vlerësimin e këtij rregullimi në kuadrin e reformës rregullatore sipas ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. (2) Tarifat që do të miratohen të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, kosto të cilat duhet të jenë të nevojshme për marrjen e këtyre shërbimeve.

Tregu i qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës

KK, me vendimin nr. 512, datë 17.05.2018, vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës”.

KK vlerësoi se mund të ndodheshim përballë një situatë urgjence për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, me vendimin nr. 542, datë 04.09.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës”. KK vendosi marrjen e masave të përkohshme ndaj ndërmarrjes EKMA Albania SHPK.

Në përfundim të procedurës, KK me vendimin nr. 572, datë 22.11.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes EKMA në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro – Ushqimore në qytetin e Tiranës”, vendosi ndërmjet të tjerave (1) Gjykitjen e ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK për shkelje të rëndë të konkurrencës, në masën 9.99 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar (2017), përkatësisht në shumën 43,168,617 lekë. (2) Detyrimin e ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK për të ndaluar shkeljen e konkurrencës dhe brenda 30 ditëve të marrë masat e nevojshme, si vijon: (i) Hartimin e kontratave të qirasë bazuar në dispozitat e Kodit Civil (për kontratën e qirasë) për të vendosur palët e saj,

qiramarrësin dhe qiradhënësin në kushte të barabarta kontraktuale në zbatim të ligjit dhe zakoneve të mira tregtare. (ii) Qiradhënësi të aplikojë çmime të arsyeshme të orientuara drejt kostos dhe çmimit mesatar të qirasë të zonës gjeografike. (iii) Qiradhënësi të jetë transparent në detajimin e zërave dhe vlerave përkatëse që përfshihen në faturën e qirasë së ambientit. (iv) Ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK të ndalojë menjëherë faturimin mbi çmimin ligjor të miratuar nga institucionet kompetente (faturuar nga OSHEE dhe UKT).

VKK është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit të Shkallës së Parë.

Tregu i energjisë elektrike

ERE, gjatë vitit 2018, ka dërguar për opinion pranë AK projekt aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Nga shqyrtimi i projekt akteve të ardhura dhe në zbatim të neneve 9, 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, KK u shpreh me vendimet si më poshtë:

1. Vendim nr. 520, datë 31.05.2018 “Për dhënien e rekomandimeve për metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, me anë të të cilit u vendos t’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë: (1) Të marrë në konsideratë që kostot administrative për llogaritjen e çmimit të furnizuesit të mundësisë së fundit të jenë të arsyeshme, aktuale dhe transparente; (2) Çdo rishikim i çmimeve afatgjata (vjetore) të bëhet mbi bazën e të dhënave reale, të cilat duhet të jenë transparente duke siguruar një çmim jo diskriminues.
2. Vendim nr. 527, datë 14.06.2018 “Për dhënie rekomandimi Entit Rregullator të Energjisë lidhur me kontratën tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE dhe PPE”, me anë të të cilit u vendos: t’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë: Në kontratën e shitblerjes së energjisë midis OSHEE dhe PPE të pasqyrohen drejt parashikimet ligjore lidhur me afatin e kontratave dhe rregullimin e çmimit duke e orientuar atë drejt kostove reale të investimeve, bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së tyre dhe me një kohëzgjatje të arsyeshme.

Tregu i gazit natyror

ERE, gjatë vitit 2018, ka dërguar për opinion pranë AK projekt aktet nënligjore, në zbatim të ligjit Nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. Nga shqyrtimi i projekt akteve të ardhura dhe në zbatim të neneve 9, 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, KK u shpreh me vendimin e mëposhtëm:

1. Vendim nr. 550, datë 04.10.2018 “Për dhënien e rekomandimeve për Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA”, me anë të të cilit u vendos t’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë: Kodi i Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të

Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij sipas parashikimeve të Vendimit nr. 2018/02/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përherëshëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë dhe Rregullores së Bashkimit European (BE) nr. 715/2009.

2.4.1.2 Hetime në vijim

Tregu i importit, prodhimit dhe tregimit të miellit

Në përfundim të procesit të monitorimit, duke qenë se sjellja e ndërmarrjeve në tregun e importit dhe prodhimit të miellit në RSH, në këndvështrimin e nivelit të çmimit, cilësisë së prodhimit mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, KK, me vendimin nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun importit, prodhimit dhe tregimit të miellit”, ka vendosur hapjen e hetimit paraprak në këtë treg.

Kjo procedurë është në fazën e përpunimit të informacionit të administruar dhe hartimit të raportit me gjetjet e hetimit.

Tregu i prodhimit dhe tregimit të naftës bruto


KK, me vendimin nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Bankers Petroleum Albania” LTD në tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto”, vendosi hapjen e hetimit në këtë treg. Meqënëse në ankesat e depozituara nga ndërmarrjet është kërkuar dhe marrja e masave të përkohshme për ndërmarrjen Bankers, AK më datë 11.12.2018, realizoi një seancë dëgjimore me ndërmarrjet ankimese dhe ndërmarrjen Bankers. KK, me vendimin nr. 578, datë 20.12.2018 vendosi “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore, dhe Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, KK vendosë gjoha periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore

PJESA E TRETË

AUTORITETI I KONKURRENCËS PËRBALLË PROCESIVE GJYQËSORE

Gjatë vitit 2018 janë dhënë 86 vendime nga KK, nga të cilat 6 prej tyre janë ankimuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ka vazhduar gjykimi edhe për çështjet e mbartura, në Gjykatën Administrative të Apelit si dhe në Gjykatën e Lartë – Kolegji Administrativ.



3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (2018)

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë gjykuar 4 (katër) çështje, nga të cilat për 1 (një) prej tyre gjykata ka vendosur mospranimin e padisë për një prej kërtimeve të palës paditëse dhe pranimin për kërkimin tjetër, kurse për 3 (tre) çështjet e tjera, gjykata ka vendosur shfuqizimin e vendimit të KK.

1. Çështja gjyqësore me paditës Shoqërinë “Vodafone Albania” SHA, të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i vendimit nr. 495, datë 08.02.2018 të KK “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA për mospërbushjen e detyrimit të vendosur nga KK në vendimin nr. 475, datë 21.09.2017” dhe shfuqizimi i pikës 3 të vendimit nr. 475, datë 21.09.2017 të KK “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve”. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi të lërë në fuqi pikën 3 të vendimit nr. 475, datë 21.09.2017 të KK dhe të shfuqizojë vendimin nr. 495, datë 08.02.2018 të KK, për pjesën e palës paditëse. Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
2. Çështja gjyqësore me paditës Shoqërinë “Telekom Albania” SHA, të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit nr. 495, datë 08.02.2018 të KK. Lidhur me këtë çështje,

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi të pranojë kërkesë padinë duke vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 495, datë 08.02.2018 të KK, për pjesën e palës paditëse. Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

3. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Ekma Albania “SHPK, të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i vendimit të AK me nr.542, datë 04.09.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendosi të pranojë kërkesë padinë duke shfuqizuar vendimin e AK. Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Çështja gjyqësore me paditës Shoqërinë “Geci” SHPK, të paditur AK dhe Zyra e Përmbartimit Tiranë, me objekt: Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv vendim nr. 229, datë 03.07.2012 të KK. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vendosi prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin ishte pranuar kërkesë padia, si dhe kthimin për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë.

Mbeten për t’u gjykuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë 2 çështjet të tjera (Tabela 2).

3.2 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Apelit (2018)

Në Gjykatën Administrative të Apelit janë gjykuar 5 (pesë) çështje, për të cilat gjykata është shprehur në favor të AK duke rrëzuar kërkesë paditë e depozituara nga pala paditëse.

1. Çështja gjyqësore me paditës Shoqërinë “Telekom Albania” SHA, të paditur AK, me objekt: Konstatim i pavlefshmërisë dhe/ose anulimi tërësisht i vendimit nr. 59, datë 09.11.2007 të KK. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vendosi të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë së palës paditëse.
2. Çështja gjyqësore me paditës Shoqërinë “Tirana Urban Trans” SHA, të paditur Autoriteti i Konkurrencës dhe Zyra e Përmbartimit Tiranë, me objekt: Shfuqizimi i vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 të KK për shkak të parashkrimit nga ligji. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vendosi të ndryshojë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur përfundimisht rrëzimin e kërkesë padisë së palës paditëse.
3. Çështja gjyqësore me paditës Shoqërinë “Landeslease” SHA, të paditur AK, me objekt: Konstatim i pavlefshmërisë dhe/ose anulimi tërësisht i vendimit nr. 412, datë 21.04.2016 të KK. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vendosi të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë së palës paditëse.

4. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Hyundai” SHPK, i paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i aktit administrativ, vendimi i KK nr.154, datë 01.10.2010 “Për ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve “Classic” SHPK, “Hyundai Auto Albania” SHPK, “Noti” SHPK dhe “Ultra Motors” SHPK dhe vendosje gjobe ndaj tyre për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”, lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, me vendimin nr.4553, datë 21.09.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë, duke lënë në fuqi vendimin e AK. Kundër këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Kjo gjykatë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së parë duke u shprehur në favor të Autoritetit të Konkurrencës.
5. Çështja administrative me kërkesë ndërmarrjen “EMS APO”, person i tretë AK, me objekt Pezullimi tërësisht i masave të përkohshme, të vendosura me vendimin e KK nr.451, datë 28.02.2017 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me vendimin nr.80-2017-3056, datë 10.07.2017, ku është vendosur: Rrëzimi i kërkesë padisë dhe lënia në fuqi e vendimit të AK. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Çështje të mbartura për gjykim nga Gjykata Administrative e Apelit (2019) -Mbeten për t’u gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit 6 (gjashtë) çështje gjyqësore, për të cilat pritet caktimi i datave respektive (Tabela 2).

3.3 Çështje të gjykuara nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (2018)

Në Gjykatën e Lartë Tiranë për periudhën raportuese kanë qenë në proces gjykimi 10 çështje gjyqësore lidhur me vendimet e KK, nga të cilat 1 çështje ka qenë në dhomë këshillimi nga ku është vendosur që të kalojë në seancë gjyqësore, ndërsa çështjet e tjera nuk janë gjykuar.

1. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Alba Trans” SHPK, i paditur AK, me objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 të KK, për pjesën që i takon paditësit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi të pranojë padinë e kësaj ndërmarrjeje. Kundër këtij vendimi nga ana e AK është kryer ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, në lidhje me këtë çështje, shpalli moskompetencën lëndore në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr. 2981, datë 11.07.2014 vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs pala e paditur, AK. Është zhvilluar një proces gjyqësor në dhomë këshillimi nga kjo gjykatë, ku është vendosur kalimi në seancë gjyqësore.

Për vitin 2019 , janë 9 (nëntë) çështje të mbartuara për gjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë (Tabela 2).

Gjykata Adm. Shk. I	Gjykata Adm. Apel	Gjykata e Lartë
Padi	Ankim	Rekurs
Vodafone Albania	Telekom Albania	Alba Trans
Telekom Albania	Tirana Urban Trans	AMC
EKMA	Landeslease	Tirana Lines
Geci	Hyundai	Tirana Urban Trans
EKMA	EMS APO	Nazeri & Dea
SGS	Vodafone Albania	AMC
	Telekom Albania	Ultra-Motors
	EMS APO	Ferlut
	Tirana-Lines	Eurogjici & Toni
	Armo	Tirana Urban Trans
	Ekma Albania	
6	11	10

3.4 Ekzekutimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës

Edhe për vitin 2018, AK ka patur në fokus mundësinë e ekzekutimit të vendimeve të marra nga KK përgjatë viteve, përfshirë edhe vendimet e marra gjatë 2018, të cilët përbëjnë tituj ekzekutivë. Përgjatë 2018 janë ekzekutuar 5 vendime të rëndësishme të KK, si më poshtë:

1. Është ekzekutuar gjoba e vendosur ndaj AMC SHA, me vendimin nr. 59, datë 09.11.2007 “Vendosje gjobe ndaj AMC Sha dhe Vodafone Sha”, për të cilin është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit nga Gjykata Vlera e Ekzekutuar është 211,522,000 lekë;
2. Është ekzekutuar në mënyrë vullnetare gjoba e vendosur me vendimin nr. 504, datë 29.03.2018 “Mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë Valtelina SHPK nga shoqëria ALB-ERK SHPK”. Vlera e gjobës së vendosur dhe së ekzekutuar është në shumën 971,200 lekë.
3. Është ekzekutuar në mënyrë vullnetare gjoba e vendosur me vendimin nr.528, datë 25.06.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 89% të aksioneve të Autovizion SHA tek Bolv Oil SHA”. Vlera e gjobës së vendosur dhe së ekzekutuar është në shumën 500,000 lekë.

4. Është ekzekutuar gjoba e vendosur me vendim nr. 535, datë 17.07.2018 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK për marrëveshje të ndaluar në tregun e prokurimeve publike”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka lëshuar Urdhrin e Ekzekutimit. Gjoba e ekzekutuar është në shumën 100,000 (një qind mijë) lekë për secilën ndërmarrje.
5. Është ekzekutuar gjoba e vendosur me vendimin nr.562, datë 15.10.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka lëshuar Urdhrin e Ekzekutimit. Shuma e gjobës së ekzekutuar është 51,091,005 lekë.
6. Është ekzekutuar gjoba e vendosur me vendimin nr. 495, datë 08.02.2018 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” për mospërmbushjen e detyrimit të vendosur nga KK në vendimin nr. 475, datë 21.09.2017”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka lëshuar Urdhrin e Ekzekutimit. Gjoba e vendosur ndaj Vodafone është në shumën prej 3,011,173 lekë dhe gjoba e vendosur ndaj Telecom në shumën prej 1,779,108 lekë.

Vendimi nr.572, datë 22.11.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”. Është lëshuar i Urdhrit të Ekzekutimit nga Gjykata e Administrative të Shkallës së parë (gjoba në shumën prej 43,168,617 lekë) .

Cështja është ankimuar në Gjykatë, e cila ka vendosur pezullimin e gjovës. Është ushtruar e drejta e ankimit të vecantë, në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Nr.	Gjobat e vjela gjatë 2018	Lekë
1.	ALB ERK VKK nr. 504 dt. 29.03.2018	971,200
2.	BOLV-OIL VKK nr. 528, dt 25.06.2018	500,000
3.	Vodafone VKK nr. 495 dt. 08.02.2018	3,011,173
4.	Telekom VKK nr. 495 dt. 08.02.2018	1,779,108
5.	AMC VKK nr .27 dt 12.12.2005	211,552,000
6.	AEK & CO VKK nr. 535 dt. 17.7.2018	100,000
7.	Tea-D VKK nr. 535 dt. 17.7.2018	100,000
8.	SGS VKK nr. 562 dt. 25.10.2018	51,091,005
Totali		269,104,486

PJESA E KATËRT

ROLI I AUTORITETIT TË KONKURENCËS NË FORMULIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE TË TJERA - ADVOKACIA E KONKURENCËS

4.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt akteve normative

Gjatë vitit 2018, AK ka marrë në shqyrtim dhe vlerësim në përputhje me ligjin nr.9121/2003, si me kërkesë të institucioneve propozuese, apo edhe me nismën e vet, ka vlerësuar (*ex-ante dhe ex-post*) si vijon:

2 (dy) projektligje:

- Projektligji “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”;
- Projektligji “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë së naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

2 (dy) projekt akte normative si vijon:

- Projekt-vendim “Për autorizimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për lidhjen e kontratave të posaçme .
- Projekt-vendim “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”(MSHMS).

37(tridhjetë e shtatë) projekt akte normative në tregun e energjisë: ERE, gjatë vitit 2018, ka dërguar për opinion pranë AK, projekt aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe ligjit nr.138/213 “Për burimet e rinovueshme” (Tabela 3).

4 (katër) projekt akte normative në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave: ERRU gjatë vitit 2018 ka sjellë për opinion mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Skrapar SHA; Gramsh SHA; Vau i Dejës SHA Librazhd-Prrenjas.

4.2 Advokacia e Konkurrencës

Advokacia e konkurrencës përbën një nga shtyllat kryesore të ligjit nr. 9121/2003.

Gjatë vitit 2018 në funksion të advokacisë, AK ka realizuar një sërë aktivitetesh si më poshtë:

4.2.1 Seminari “Për Kontrollin e përqendrimeve” në bashkëpunim me OECD-GVH/RCC

Në bashkëpunim me “OECD-GVH/RCC”, AK, në datat 19-21 qershor 2018 zhvilloi seminarin 3 ditor në Tiranë "Për kontrollin e përqendrimeve", me përfaqësues nga 27 Autoritete homologe të Konkurrencës nga Evropa dhe Azia. Ky organizim u bë i mundur në sajë të vlerësimit të kontributit që AK ka dhënë gjatë viteve të fundit në marrëdhëniet ndërkombëtare midis Autoriteteve të Konkurrencës.

4.2.2 Forumi “Konkurrenca dhe Biznesi”

Në 14 dhjetor 2018, AK zhvilloi në Tiranë Forumin “Konkurrenca dhe Biznesi”, në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, entet rregullatore (AKEP; ERE; Komisioneri IDP), dhe përfaqësues të biznesit (Konfindustria, Dhoma e Industrisë dhe Tregëtisë Tiranë dhe përfaqësues të studiove ligjore).

4.2.3 Tryezat e Rrumbullakëta

Në kuadër të rritjes dhe ndërgjegjësimit për një mjedis konkurrues, gjatë muajve tetor-nëntor 2018, u organizuan 3 tryeza të rrumbullakëta me titull “Konkurrenca në funksion të zhvillimit ekonomik” me komunitetet e biznesit, në qytetet e Kukësit (30 tetor 2018), Korçës (16 nëntor 2018) dhe Beratit (23 nëntor 2018). Konkretisht në qytetin e Kukësit aktiviteti u zhvillua në bashkëpunim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës me fokus zhvillimin e një tregu rajonal Shqipëri-Kosovë.

4.2.4 Marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe ente rregullatore

AK, në zbatim të Rezolutës/2017, ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe ente të tjera rregullatore, si më poshtë:

- Autoriteti i Konkurrencës me AKEP, nr. 286 prot., datë 04.05.2018;
- Autoriteti i Konkurrencës me ERRU, nr. 588 prot., datë 17.10.2018;
- Autoriteti i Konkurrencës dhe Posta Shqiptare SHA, nr. 606 prot., datë 24.10.2018;
- Autoriteti i Konkurrencës me Drejtorinë e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, nr. 620 prot., datë 01.11.2018;
- Autoriteti i Konkurrencës me Autoritetin e Mediave Audiovizive, nr. 643 prot., datë 12.11.2018

PJESA E PESTË

INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

5.1 Kontributi në kuadrin e Integrimit Evropian

Procesi i integritit përbën një nga prioritetet dhe sfidat e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Si një institucion lider për kapitullin e 8-të “Politika e konkurrencës dhe liberalizimi”, AK, gjatë vitit 2018 ka përmbushur misionin e tij fokusuar në këto drejtime kryesore:

Në kuadër të PKIE në terma afatmesëm, për vitet 2017-2020, për kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, AK, në respektim të afateve kohore, ka realizuar përafrimin e legjislacionit të konkurrencës me *acquis* të BE, përkatësisht dy akte sekondare:

- Udhëzimin nr.1, datë 25.06.2018 “Për kufizimet drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme me përqendrimet”, i cili është përafruar plotësisht me njoftimin e Komisionit mbi kufizimet drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për përqendrimet⁵.
- Udhëzimin nr. 2, datë 20.12.2018 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës në vlerësimin e marrëveshjeve të aksesit në sektorin e telekomunikacionit”⁶.

5.2 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Gjatë veprimtarisë së vitit 2018, AK ka synuar forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe, forumet dhe qendrat e trajnimeve të konkurrencës në rajon e më gjerë, duke marrë pjesë në aktivitetet si më poshtë:

Memorandume Mirëkuptimi:

- Memorandum Mirëkuptimi midis Autoritetit të Konkurrencës Turk “Rekabet” dhe AK, në datat 17-19 shtator 2018, në Ankara, Turqi.
- Memorandum Mirëkuptimi midis Autoritetit të Konkurrencës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të Maltës dhe AK, në datat 2-5 dhjetor 2018 në Tiranë.

⁵ Sipas njoftimit të Komisionit Evropian (2005/C 56/03) “Për kufizime drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme me përqendrimet”. CELEX-52005XC0305(02).

⁶ Direktiva 2014/104/EU e datës 26 Nëntor 2014 mbi rregullat lidhur me veprimet për dëmet sipas ligjeve kombëtare të shteteve anëtare dhe BE-së, për shkelje të dispozitave të ligjit të konkurrencës (32014L0104)

Aktivitete:

- Në datat 11-13 korrik 2018, në Gjenevë u organizua nga **UNCTAD** takimi i 17' i "Grupit Ndërqeveritar të Ekspertëve mbi Konkurrencën, Ligjin dhe Politikat - IGE". Në këtë sesion të OKB, Kryetarja e AK drejtoi ditën e dytë të punimeve të këtij takimi dhe në të njëjtën kohë, ajo ishte *rapporteur* për gjithë këtë takim.
- AK mori pjesë në sesionin e 66^{-të} të Takimit Vjetor të Pranverës për Antitrust Law Session në datat 11-13 prill 2018 në Washington DC, SHBA, organizuar nga **American Bar Association** dhe u prezantua me punimin "Promovimi i konkurrencës në ekonomitë e vogla".
- Në datat 29-30 nëntor 2018, nga **OECD** në Paris u zhvillua Forumi i 17^{-të} Botëror i Konkurrencës, ku AK paraqiti për herë të parë kontributin e eksperiencës së institucionit midis 27 shteteve pjesëmarrëse në këtë forum, në dy sesione, përkatësisht në atë të "Bashkëpunimit Rajonal për Konkurrencën" dhe në sesionin për "Fuqitë Investigative në Praktikë".

AK, gjatë vitit 2018, AK është angazhuar në pjesëmarrjen në disa trajnime të **TAIEX**:

- Në datat 19-20 mars 2018 u zhvillua Misioni i Ekspertëve mbi "Procedurat e përqendrimeve" në bashkëpunim me ekspertë nga Autoriteti i Konkurrencës Italian dhe Lituanëz.
- Në datat 17-19 shtator 2018 u zhvillua një vizitë studimore me temë "Analiza Ekonomike dhe Vlerësimi Ligjor në fushën e Konkurrencës" në bashkëpunim me Autoritetin Austriak të Konkurrencës (BWB) në Vjenë, Austri.
- Në datat 3-5 tetor 2018, në ambjentet e AK u zhvillua Misioni i Ekspertëve mbi "Sjellja e Njëanshme dhe Sjelljet e Koordinuara (Kartelet)", në bashkëpunim me Zyrën Federale Gjermane e Kartelave Bundeskartellamt dhe Autoritetit të Konkurrencës së Lituanisë.

Gjatë vitit 2018, Autoriteti i Konkurrencës vijoi bashkëpunimin me **OECD-GVH/RCC** nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme që kjo qendër ofron për vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. AK mori pjesë në aktivitetet e mëposhtme:

- Në datat 28-30 nëntor 2018, AK mori pjesë në konferencën "Konkurrenca dhe Korrupsioni" e zhvilluar në Paris nga rrjetit OECD-GVH/RCC për Europën Juglindore.
- Në datat 6-8 mars 2018, AK mori pjesë në seminarin "Mekanizmat për zbulimin e karteleve" organizuar në Budapest, Hungari.
- AK vijon komunikimin nëpërmjet rrjetit të shkëmbimit të informacionit (Request for Information – RFI) midis autoriteteve homologe, për çështje apo problematika që ato hasin në punën e përditëshme të tyre dhe për të cilat kërkohet dhënia e përgjigjeve adekuate.
- AK ka publikuar dy artikuj në Newsletter në lidhje me temat:
 - a) "Mobile Phones Dominating not only Our Lives, but also Competition";
 - b) "Competition Advocacy Experience of the Albanian Competition Authority".

AK, edhe gjatë vitit 2018, ka vijuar të jetë pjesëmarrëse e grupeve të ndryshme të punës, pjesë të **International Competition Network**, përkatësisht: (1) Grupi punës për avokacinë (Advocacy Working Group); (2) Grupi punës për efektivitetin e autoritetit (Agency Effectiveness Working

Group); (3) Grupi punës për kartelet (Cartel Working Group); (4) Grupi punës për përqendrimit (Mergers Working Group); (5) Grupi punës për sjelljen e njëanshme në rastet e abuzimit të pozitës dominuese (Unilateral Conduct Working Group).

Gjatë vitit 2018, AK ka marrë pjesë në eventet e mëposhtme të **Komunitetit e Sekretariatit të Energjisë (ECS)**: “Përvetësimi i Konkurrencës Evropiane dhe acquis i ndihmes shtetërore në sektorët e energjisë” në 7 dhjetor 2018, Vjenë, Austri; Forumi i 6^{-të} i Vjenës për “Ligjin Evropian të Energjisë” në 27-28 shtator 2018, Vjenë, Austri.

AK ka paraqitur eksperiencën shqiptare në lidhje me përgatitjen e **dy botimeve të Global Competition Review** për gjatë vitit 2018, përkatësisht: (1) The Handbook of the Competition Economics 2019; (2) The Handbook of Competition Enforcement Agencies 2018.

AK, në vijim të bashkëpunimit me **Florence Competition Programme**, ka marrë pjesë në takimet si më poshtë: “Abuzimi me pozitën dominuese sipas ligjit të BE për konkurrencën”, Romë, Itali në datën 17 janar 2018; “Zbatimi i ligjit Antitrust ne Europe pas rastit Intel dhe Cartel Bancaires”, i zhvilluar në Firence, Itali në datën 20 prill 2018.

AK, në vijim të bashkëpunimit me **GIZ**, ka marrë pjesë në takimet: (1) “Projekti Fondi i Hapur Rajonal – Reforma Ligjore” (ORF LR), zhvilluar në datën 11 prill 2018, në Beograd, Serbi; (2) “Colletive rediness procedures through injuctions” zhvilluar në datat 3-6 shtator 2018, në Bratisllave, Sllovaki.

Aktivitete të tjera- marrëdhënie me autoritetet homologe :

- Pjesëmarrje në “60 Vjetori i Autoritetit Gjerman të Konkurrencës”, zhvilluar në datat 22-23 shkurt 2018, në Bonn, Gjermani.
- Pjesëmarrje në “Konferenca vjetore e Autoritetit Serb”, zhvilluar në datën 20 prill 2018, në Beograd, Serbi.
- Pjesëmarrje në Konferencën e organizuar nga Autoriteti i Konkurrencës Italiane, Franceze, Gjermane dhe Britanike më temë “Future Perspectives on Media Markets: Competition, pluralism and regulatory oversight”, në datë 22 maj 2018, në Romë, Itali.
- Konferenca e IV "Politika kunder monopolizimit, shkencë, Praktik, Edukim"- "Konkurrenca: Moderne dixhitale, Ndërkufitare", organizuar nga Federata e Shërbimit për Antimonopolin e Federatës Ruse, zhvilluar në datat 6-7 dhjetor 2018, në Moskë, Rusi.

PJESA E GJASHTË


ORGANIZIMI I AUTORITETIT

6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës

Për vitin 2018, Autoriteti Konkurrencës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 dhe rekomandimeve të Progres Raportit (2018), ka synim forcimin e kapaciteteve dhe përshtatjen me modelin e institucioneve homologe të vendeve të BE-së.

Struktura e miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 59/2018 “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.43/2017 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Autoritetit të Konkurrencës” ka synuar kryesisht në shtimin e numrit të punonjësve prej katër punonjës në drejtoritë teknike, për të mbuluar aktivitetin në rritje, për gjithë tregjet në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e nevojave të konsumatorit shqiptar, nëpërmjet një konkurrence të lirë dhe efektive, si në tregjet prodhuese dhe ato të shërbimit. Rritja e numrit të punonjësve do të sigurojë që analizat, studimet, inspektimet dhe gjithë procedurat hetimore do të kryhen më shpejt brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Struktura organizative e AK paraqitet si më poshtë:



6.2 Të ardhura të derdhura në buxhet dhe realizimi i buxhetit të miratuar për AK për vitin 2018

Gjatë vitit 2018, AK ka derdhur në buxhetin e shtetit shumën totale **284,341,986 lekë**, nga të cilat është derdhur si e ardhur nga përqendimet (njoftim dhe autorizim përqendrimi) shuma **15,237,500 lekë**, dhe si e ardhur nga vjelja e gjobave shuma prej **269,104,486 lekë**.




Tabela e shpenzimeve të AK për vitin 2018 (për tu plotësuar pas rakordimit)

Kodi	Emërtimi	Plani (me ndryshime)	Fakti	/
		Lekë		
600	Paga , shpërblime etj	47,900,000	45,922,277	96%
601	Kontribute për Sigurime Shoqërore	8,600,000	7,059,590	82%
602	Materiale dhe Shërbime	16,155,400	15,635,184	97%
231	Investime	8,000,000	7,825,113	98%
Totali		80,655,400	76,442,161	95%

Mosrealizimi në masën 5% ishte kryesisht si rezultat i mbetjeve nga procedurat e prokurimeve.

Gjopa të derdhura në 2018: **269,104,486 lekë**.

Për herë të parë, masa e gjobave të vjela së bashku më të ardhurat e arkëtuara nga autorizimi i përqendrimeve (**284,341,986 lekë**) është **3.5 herë** më i lartë së buxheti i alokuar AK (**80,655,400 lekë**).




Të ardhurat të realizuara të derdhura në buxhet për vitin 2018



Kodi	Emërtimi	Fakti
		Lekë
	Të ardhura të derdhura në buxhet nga përqendrimet	15,237,500
711	Të ardhura të derdhura në buxhet nga vjelja e gjobave	269,104,486
Totali		284,341,986

6.3 Rekrutimet

Gjatë vitit 2018, në kuadër të plotësimit të nevojave të drejtorive teknike, janë realizuar 8 procedura rekrutimi me lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil. Të gjitha procedurat janë realizuar konform kërkesave të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe duke pasur në konsideratë sistemin e karrierës në shërbimin civil. Qëllimi në këto procedura ka qenë dhe do të mbetet pranimi i stafit me integritet profesional dhe eficient.



Gjatë vitit 2018 janë realizuar 22 trajnime jashtë vëndit dhe 2 brenda vëndit, ku është trajnuar një numër i konsiderueshëm prej 55 punonjësish të institucionit, ku një pjesë e punonjësve rezultojn të jenë trajnuar më shumë se një herë. Të gjitha trajnimet janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të AK me OECD-GVH/RCC, CRESSE, TAIEX, dhe brenda vëndit, nga Shkolla e Administratës Publike.



PJESA E SHTATË

PRIORITETET E AK PËR VITIN 2019

7.1 Prioritetet e AK për vitin 2019

- AK, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9121/2003, për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, do të vazhdojë mbikëqyrjen dhe hetimet kryesisht në tregjet me impakt të drejtpërdrejtë në interesat dhe mirëqenien e konsumatorit:
 - tregje që konsiderohen tradicionale si: *tregu i telekomunikacioneve, tregu i energjisë, tregu i hidrokarbureve, tregu financiar dhe i sigurimeve;*
 - tregje të reja si: *tregu i tregtisë elektronike, tregu i publikimit të librit, tregu farmaceutik, tregu spitalor, tregu i ofrimit të arsimit të lartë, tregu i shërbimit të profesioneve të lira, mbrojtja e të dhënave dhe konkurrenca.*
- Me qëllim evidentimin në kohë reale të transaksioneve të shitblerjes së kuotave/aksioneve, të cilat mund të jenë objekt autorizim përqendrimi nga AK, do të kërkohet bashkëpunimi me QKB për të shtuar në bazën e të dhënave të biznesit, dy fusha të posaçme në lidhje me llojin e transaksionit dhe xhiron e shoqërive pjesëmarrëse në transaksion.

7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE-së

Gjatë vitit 2019, AK do të:

- Forcojë kapacitetet administrative, nëpërmjet krijimit të një njësie të re në strukturën organizative të AK, për të qenë në koherencë me institucionet homologe, dhe kërkesat e Komisionit European - struktura specifike e KryeEkonomistit, e cila do të realizojë në mënyrë të veçantë analiza ekonomike dhe ekonometrike, si dhe do të sigurojë një qasje metodologjike dhe empirike të analizave sasiore dhe cilësore mbi të dhënat për tregjet. Numri i punonjësve prej tre vetësh është miratuar me strukturën organizative të AK me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 128/2018 dt. 20.12.2018 “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 43/2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës” për të cilat do të ndiqen procedurat e parashikuara nga ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Trajnojë stafin e ri dhe ekzistues me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit, inspektimit, hartimit të raporteve, analizave, si cilësinë e mbrojtjes së vendimeve të KK në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjyqësorit.
- Vazhdojë të zbatojë PKIE 2018-2020, si dhe detyrat që rrjedhin nga MSA, si lider i kapitullit të 8-të “Politika e Konkurrencës”.

- Ndjekë procedurat përkatëse në kuadër të projektit IPA Twinning për "Further Strengthening the Competition Authority's capacities to protect the free and effective competition in the market", (i cili është hapur për **aplikim** nga shtetet anëtare të BE-së) falë së cilit synohet forcimi i kapaciteteve institucionale të AK, në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe atij evropian në fuqi.
- Ndjekë procedurat në kuadër të projektit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) "Asistencë teknike për AK, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe advokacia", i cili është në proces tenderimi.
- Aplikojë në kuadër të TAIEX, për organizimin e një misioni ekspertësh për trajnimin e stafit për temën "Lidhja midis tregtisë elektronike dhe politika e konkurrencës".
- Angazhohet në rritjen e bashkëpunimit me institucione të tjera homologe dhe ente rregullatore, duke nënshkruar me to edhe Memorandume Mirëkuptimi (MOU).
- Miratojë disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës", të cilat do të reflektojnë eksperiencat e autoriteteve homologe të vendeve evropiane dhe eksperiencën tonë sidomos lidhur me tarifat që aplikon institucioni jonë për procedurat e kontrollit të përqendrimeve.
- Ndërmarrë nismën e rishikimit të ligjit nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" i ndryshuar, duke propozuar disa shtesa dhe ndryshime, në kuadër të përgatitjes për anëtarësim në Bashkimin Evropian, nëpërmjet identifikimit të dispozitave përkatëse të ligjit shqiptar dhe rishikimin e tyre në lidhje me përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së, por edhe duke pasqyruar problematikat, paqartësitë dhe eksperiencën në praktikë tashmë pothuajse 10 vjeçare nga momenti i rishikimit të fundit që i është bërë ligjit.
- Në kuadër të bashkëpunimit me UNCTAD, AK ka si objektiv të tij realizimin e një projekti të përbashkët me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë "Competition and Consumer Protection Policy in Albania", ku parashikohet trajnimi i stafit të AK në lidhje me vlerësimin e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta, vlerësimin e procedurave të prokurimit publik për marrëveshjet e ndaluara në oferta, vlerësimin gjatë procedurave të kontrollit të përqendrimeve, shkëmbime eksperiencash.

ANEKS

VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS

- 1 KK me vendimin nr. 493, datë 23.01.2018 vendosi “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve”.
- 2 KK me vendimin nr. 494, datë 24.01.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të plotë të shoqërisë MAK Albania SHPK nga shoqëria Kastrati SHA”.
- 3 KK me vendimin nr. 495, datë 08.02.2018 vendosi “Për vendosje gjobe ndaj ndërrmarjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” për mospërbushjen e detyrimit të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në vendimin 475, datë 21.09.2017”.
- 4 KK me vendimin nr. 496, datë 08.02.2018 vendosi “Mbi përfitim të kontrollit të plotë të shoqërisë Buse Gaz S.r.l. nga Messer Belgium N.V. në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar tërësisht prej saj Messer Romania S.r.l.”.
- 5 KK me vendimin nr. 497, datë 08.02.2018 vendosi “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteteve në Republikën e Shqipërisë”.
- 6 KK me vendimin nr. 498, datë 15.02.2018 vendosi “Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017 dhe prioritetet kryesore për vitin 2018”.
- 7 KK me vendimin nr. 499, datë 15.02.2018 vendosi “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”.
- 8 KK me vendimin nr. 500, datë 07.03.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimeve publike për ndërrmarjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK”.
- 9 KK me vendimin nr. 501, datë 15.03.2018 vendosi “Mbi shitjen dhe transferimin e aksioneve të Bankës NBG Albania SHA nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A. tek Banka Amerikane e Investimeve SHA”.
- 10 KK me vendimin nr. 502, datë 21.03.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Nestle USA Inc. nga Ferrero International S.A”.
- 11 KK me vendimin nr. 503, datë 21.03.2018 vendosi “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.490, datë 20.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërrmarjes Austrian Airlines”.
- 12 KK me vendimin nr. 504, datë 29.03.2018 vendosi “Mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë Valtelina SHPK nga shoqëria ALB-ERK SHPK”.
- 13 KK me vendimin nr. 505, datë 29.03.2018 vendosi “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit dhe dhënien e rekomandimit për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.
- 14 KK me vendimin nr. 506, datë 02.05.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve publike për ndërrmarjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK”.

- 15 KK me vendimin nr. 507, datë 02.05.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 100% të shoqërisë Inre SHPK tek Z. Grigor JOTI dhe Z. Plarent KRISTO”.
- 16 KK me vendimin nr. 508, datë 02.05.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të shoqërisë TURGUT OZAL EDUCATION SHA tek shoqëria BF COOPERATIEF U.A.”
- 17 KK me vendimin nr. 509, datë 02.05.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme”.
- 18 KK me vendimin nr. 510, datë 10.05.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 6.50 % të aksioneve të INTELLIGENT APPS GMBH, nga HNH GROUP LTD tek DAIMLER MOBILITY SERVICES GMBH”.
- 19 KK me vendimin nr. 511, datë 10.05.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit në lidhje me përfitim e kontrollit të përbashkët nga BMË dhe Daimler AG mbi disa shoqëri”.
- 20 KK me vendimin nr. 512, datë 17.05.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në “Tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”.
- 21 KK me vendimin nr. 513, datë 17.05.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 20% të aksioneve të “TV KLAN” SHA nga Z.Ervin Gjikota tek Z. Aleksandër Frangaj”.
- 22 KK me vendimin nr. 514, datë 17.05.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë, ndaj ndërmarrjes “SGS AUTOMOTIVE ALBANIA SHPK”.
- 23 KK me vendimin nr. 515, datë 22.05.2018 vendosi “Detyrimi për t’u informuar nga bankat e nivelit të dytë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të vendimit nr. 453, datë 07.03.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve për bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë” të Komisionit të Konkurrencës.
- 24 KK me vendimin nr. 516, datë 22.05.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën IntesaSanPaolo”.
- 25 KK me vendimin nr. 517, datë 22.05.2018 vendosi “Rekomandime lidhur me masat rregulluese në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”.
- 26 KK me vendimin nr. 518, datë 22.05.2018 vendosi “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Skrapar SHA”.
- 27 KK me vendimin nr. 519, datë 31.05.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një shoqërie të përbashkët, “Shushica Hydropower”SHPK, nga “Trema Engineering 2”SHPK, “GR Albania”SHPK dhe “ALB- STAR” SHPK”.
- 28 KK me vendimin nr. 520, datë 31.05.2018 vendosi “Për dhënien e rekomandimeve për metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”.

- 29 KK me vendimin nr. 521, datë 07.06.2018 vendosi “Për dhënien e rekomandimeve për Projekt-vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”.
- 30 KK me vendimin nr. 522, datë 07.06.2018 vendosi “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Gramsh SHA”.
- 31 KK me vendimin nr. 523, datë 07.06.2018 vendosi “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore, të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK”.
- 32 KK me vendimin nr. 524, datë 14.06.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit në shoqërinë SANITARY CLEANING SHPK”.
- 33 KK me vendimin nr. 525, datë 14.06.2018 vendosi “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines dhe dhënien e disa rekomandimeve”.
- 34 KK me vendimin nr. 526, datë 14.06.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”.
- 35 KK me vendimin nr. 527, datë 14.06.2018 vendosi “Për dhënie rekomandimi Entit Rregullator të Energjisë lidhur me kontratën tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE dhe PPE”.
- 36 KK me vendimin nr. 528, datë 25.06.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 89% të aksioneve të Autovizion SHA tek Bolv Oil SHA”.
- 37 KK me vendimin nr. 529, datë 25.06.2018 vendosi “Mbi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë SPORT VISION d.o.o Podgorica, Mali i Zi nga SPORT VISION d.o.o Bijeljina, Bosnjë Hercegovina”.
- 38 KK me vendimin nr. 530, datë 25.06.2018 vendosi “Për dhënien e disa rekomandimeve për Autoritetin e Mediave Audiovizive”.
- 39 KK me vendimin nr. 531, datë 25.06.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes EKMA Albania SHPK në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”.
- 40 KK me vendimin nr. 532, datë 25.06.2018 vendosi “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 509, datë 02.05.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme”.
- 41 KK me vendimin nr. 533, datë 05.07.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të SKY PCL nga COMCAST CORPORATION”.
- 42 KK me vendimin nr. 534, datë 05.07.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të 100% të aksioneve të shoqërisë FINAL SHA tek IUTECREDIT ALBANIA SHA”.
- 43 KK me vendimin nr. 535, datë 17.07.2018 vendosi “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK për marrëveshje të ndaluar në tregun e prokurimeve publike”.

- 44 KK me vendimin nr. 536, datë 20.07.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga UNITED MEDIA mbi DIRECT MEDIA, MEDIA POINT, PINK BH dhe PINK MNE”.
- 45 KK me vendimin nr. 537, datë 20.07.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të BFSE HOLDING B.V tek shoqëria AMRYTA CAPITAL LLP.”
- 46 KK me vendimin nr. 538, datë 20.07.2018 vendosi “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror në Republikën e Shqipërisë”.
- 47 KK me vendimin nr. 539, datë 24.07.2018 vendosi “Mbi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Hygeia Hospital Tirana SHA nga Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens, Hygeia S.A tek American Hospital Sha ”.
- 48 KK me vendimin nr. 540, datë 24.07.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të SIEMENS A.G me ALSTOM S.A”.
- 49 KK me vendimin nr. 541, datë 04.09.2018 vendosi “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 531, datë 25.06.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes EKMA Albania SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”.
- 50 KK me vendimin nr. 542, datë 04.09.2018 vendosi “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”.
- 51 KK me vendimin nr. 543, datë 20.09.2018 vendosi “Për mos klasifikim si përqendrim të njoftimit për transferimin e 85% të kuotave të shoqërisë CC TIRANA SHPK tek COMDATA S.p.A”.
- 52 KK me vendimin nr. 544, datë 20.09.2018 vendosi “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 526, datë 14.06.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”.
- 53 KK me vendimin nr. 545, datë 20.09.2018 vendosi “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 516, datë 22.05.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën IntesaSanPaolo”.
- 54 KK me vendimin nr. 546, datë 24.09.2018 vendosi “Për dhënie mendimi lidhur me ligjin nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”.
- 55 KK me vendimin nr. 547, datë 24.09.2018 vendosi “Për dhënien e rekomandimeve për rritjen e konkurrencës gjatë procesit për dixhitalizimin e transmetimeve audiovizive”.
- 56 KK me vendimin nr. 548, datë 24.09.2018 vendosi “Për shqyrtimin e kërkesës së ERRU për revokimin e disa vendimeve të Komisionit të Konkurrencës”.
- 57 KK me vendimin nr. 549, datë 27.09.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët “AIR ALBANIA” SHPK”.

- 58 KK me vendimin nr. 550, datë 04.10.2018 vendosi “Për dhënien e rekomandimeve për Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA”.
- 59 KK me vendimin nr. 551, datë 04.10.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit”.
- 60 KK me vendimin nr. 552, datë 04.10.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”.
- 61 KK me vendimin nr. 553, datë 04.10.2018 vendosi “Mbi vlerësimin ligjor të p/kontratës së Koncesionit/PPP për ofrimin e shërbimeve diagnostikuese nga laboratorët mjekësorë”.
- 62 KK me vendimin nr. 554, datë 08.10.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga Messer Group GmbH dhe Yeti Investments S.a.r.l mbi disa asete të Linde Aktiengesellschaft dhe Praxair Inc nëpërmjet MG Industries GmbH”.
- 63 KK me vendimin nr. 555, datë 08.10.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga INA INDUSTRIJA NAFTE d.d. dhe PRVO PLINARSKO DRUSTVO d.o.o mbi PETROKEMIJA d.d”.
- 64 KK me vendimin nr. 556, datë 08.10.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërive First Data Slovakia S.R.O dhe First Data Hellas Processing Services and Holdings S.A. nga shoqëria SIA S.p.A.”.
- 65 KK me vendimin nr. 557, datë 08.10.2018 vendosi “Mbi vlerësimin e projekt-vendimit të Entit Rregullator të Ujit lidhur me aplikimin për ndryshimit të nivelit tarifor për “Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas” SHA”.
- 66 KK me vendimin nr. 558, datë 08.10.2018 vendosi “Mbi vlerësimin e projekt-vendimit të Entit Rregullator të Ujit lidhur me aplikimin për ndryshimit të nivelit tarifor për “Ujësjellës Kanalizime Vau i Dejës” SHA”.
- 67 KK me vendimin nr. 559, datë 15.10.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët mbi një ndërmarrjeje të re nga Dr.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft dhe Schuler Aktiengesellschaft”.
- 68 KK me vendimin nr. 560, datë 15.10.2018 vendosi “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore, të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve”.
- 69 KK me vendimin nr. 561, datë 15.10.2018 vendosi “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme”.
- 70 KK me vendimin nr. 562, datë 25.10.2018 vendosi “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve”.
- 71 KK me vendimin nr. 563, datë 25.10.2018 vendosi “Mbi miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës””.

- 72 KK me vendimin nr. 564, datë 25.10.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”.
- 73 KK me vendimin nr. 565, datë 29.10.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të GORENJE GOSPODINJSKI APARATI D. D. nga HISENSE GROUP CO. LTD”.
- 74 KK me vendimin nr. 566, datë 07.11.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët nga Daimler FS dhe nga Volkswagen FS mbi Mobility Trader Holding GmbH.”
- 75 KK me vendimin nr. 567, datë 07.11.2018 vendosi “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS- Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe dhënien e disa rekomandimeve”.
- 76 KK me vendimin nr. 568, datë 15.11.2018 vendosi “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare”.
- 77 KK me vendimin nr. 569, datë 15.11.2018 vendosi “Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK për revokimin e vendimit nr. 560, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës”.
- 78 KK me vendimin nr. 570, datë 22.11.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Danske Commodities A/S nga Equinor Refining Norëay AS”.
- 79 KK me vendimin nr. 571, datë 22.11.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së aksioneve prej 88.89% tek Societe Generale Albania SHA nga Societe Generale tek OTP Bank Nyrt.”
- 80 KK me vendimin nr. 572, datë 22.11.2018 vendosi “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës”.
- 81 KK me vendimin nr. 573, datë 26.11.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”.
- 82 KK me vendimin nr. 574, datë 26.11.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Tregun e Profesioneve të Lira”.
- 83 KK me vendimin nr. 575, datë 03.12.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Bankers Petroleum Albania” LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto.”
- 84 KK me vendimin nr. 576, datë 11.12.2018 vendosi “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare SHA nga Union Bank SHA”.
- 85 KK me vendimin nr. 577, datë 20.12.2018 vendosi “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.
- 86 KK me vendimin nr. 578, datë 20.12.2018 vendosi “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”.
- 87 KK me vendimin nr. 579, datë 20.12.2018 vendosi “Për fillimin e procedurës së thelluar në vlerësimin e transaksionit të ndodhur midis Piraeus Bank SA dhe Balfin SHPK e Komercijalna Banka Ad Skopje”.



**AUTORITETI I
KONKURRENCËS**

Rruga SAMI FRASHËRI, nr. 4, kati IV,
Tiranë 1004

+355 42234504
competition@caa.gov.al
caa.gov.al